

Kumbona e së Diellës



Papa Françesku në Maqedoninë e Veriut

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2019

PAPA FRANÇESKO ME 7 MAJ 2019, VIZITOJË MAQEDONIN E VERIUT

Pas mbërritjes në Shkup, më 7 maj, Ati i Shenjtë u prit në oborrin e Pallatit Presidential, dhe bëri një vizitë kortezie presidentit të Republikës dhe i foli popullit maqedonas në takim me autoritetet, shoqërinë civile dhe Trupin Diplomatik. Pastaj, pjesa tjetër e vizitës, u kushtua krejtësisht shenjtës shqiptare të bamirësisë, Nënë Terezës e lindur në Shkup. Papa vizitojë Memorialin e saj, ndërtuar aty ku ndodhej kisha e Zembrës së Krishtit, shkatërruar nga tërmeti i vitit 1963. Aty është pagëzuar Nënë Tereza. “Memoriali – deklaroi sot Gisotti – është ndërtuar në një zonë të shkatërruar krejtësisht”, duke pohuar edhe se gjatë qëndrimit të Papës në Shkup “aty u zhvilluan çaste lutjeje me krerët fetarë të vendit, në kapelën ku ndodhen reliktet e Nënë Terezës.

Në orën 11.30, celebrimi eukaristik në sheshin Maqedonia, ku ishin të pranishëm rreth 15 mijë vetë, ndërmjet të cilëve, edhe besimtarë, meshtarë të shumtë, ipeshkvij nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe diaspora. Me dy, takimet e pasdites: me të rinjtë, në qendrën baritore të dioqezës dhe, me klerin, në katedralen e Zembrës së Krishtit, përfundoj vizita historike e Papa Françeskut në këtë trevë të vjetër ilire. Në përfundim ipeshkvi i Shkupit, imzot Kiro Stojanov, e përshëndeti dhe e falënderoi Papën Françesku për vizitën e tij në Maqedoninë e Veriut.





Kard. Pietro Parolin
NË KUJTIM TË PËRJETSHËM 4

Giovanni Cussi S.I.
SFIDA KULTURORE E VIDEO-LOJËRAVE 7

Don Nosh Gjolaj
KRIZA E IDENTITETIT SI MASHKULL
DHE SI BABË 11

Dom Nikë Ukgjini
ASIMILIMI I SHQIPTAREVE NË MAQEDONI 15

Don Lush Gjergji
VIZITË TROJEVE DARDANE 18

Mërgim Korça
HISTORIA DHE
MUSTAFA MERLIKA KRUJA 23

Lekë Mrijaj
PIETRO PAROLINI NË KOSOVË 26

Redaksia
7 SHENJTORËT 27

VITRINA E LIBRIT 28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXII, nr. 5/6 (519-520) Maj - Qershor 2019

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

ATI I SHENJTË PAPA FRANÇESKU

NË KUJTIM TË PËRJETSHËM

«Një shumicë në Izrael qenë të guximshëm e qëndroi e fortë e nuk hëngri ushqime të papastërta: më parë zgjodhën vdekjen se të ndoten me ushqime të papastërta e ta prishin Besëlidhjen e shenjtë»
(1Mak 1,62-63).

Ashtu siç na mëson Libri i Parë i Makabejve, në vorbullën e përndjekjeve nuk mungonin ata që për dashuri ndaj Hyjit dhe ligjit të Tij duronin me qëndresë të qetë dhe në paqe mundimet e shumëfishta dhe që qenë të gatshëm ta jepnin jetën e tyre për ta gjetur atë në Hyjin. Ndërsa përndjekësit zhduken si hije në errësirën e një harrese të përrjetshme, martirët shkëlqejnë si shkëndijë drite në qiell.

Në këtë mënyrë edhe të Nderuarit Shërbëtorë të Kishës në Shqipëri, viktimat të përndjekjes së shek. XX, kanë sjellë fitoren, duke qenë se kanë treguar ndaj armiqve po ato ndjenja dhe qëndrime që ka pasur edhe Krishti (Fil 2,5): falje, ndershmëri, qëndresë, vëllazëri, zemërdhembshuri. Historia e vuajtjeve, e martirizimit dhe e lavdërimit të këtyre XXXVIII heronjve të fesë, filloi në vitin 1944, kur një fuqi e padrejtë dhe e mbrapshtë pretendoi ta

fshinte emrin Shumë të Shenjtë të Zotit prej tokës fisnike të Shqipërisë. Megjithatë, feja nuk arriti kurrë të çrrënjosej prej këtij vendi. Zoja e Këshillit të Mirë, Pajtorja e Kombit shqiptar, prej shenjtërores së saj të përdhosur të Shkodrës, vazhdoi të rrezatonte në zemrat e besimtarëve ngushëllim dhe shpresë.

Përndjekja, që zgjati për më shumë se 40 vjet, u bë kundër çdo tipologjie e klase besimtarësh, klerikësh, rregulltarësh dhe laikësh, të rinj dhe të moshuar, të çdo prejardhjeje sociale dhe kulturore. Ata u vranë mizorisht, u poshtëruan në gjyqe të rreme publike, u akuzuan për komplete që nuk kishin ndodhur kurrë. Këta martirë janë:

I - *Vinçenc*, në shekull Nicolò, *Prennushi*, O.F.M., Ipeshkvi i parë i Sapës dhe pastaj Arqipeshkëv dhe Primat i Shqipërisë. Iu kundërvua përpjekjes për ta nacionalizuar Kishën, duke e shkëputur atë prej Romës: vdiq më 19 mars 1949 në burgun e Durrësit për shkak të keqtrajtimit.

II - *Frano Gjini*, Ipeshkvi i parë me titull *Sempte* dhe abati *nullius* i Shën Llezhdrit të Oroshit, pra ipeshkvi i Lezhës që protestoi kundër politikës antifetare të regjimit: u pushkatua në Shkodër më 11 mars 1948.

Së bashku me të vdiqën edhe dy françeskanë:

III - *Çiprijan Nikaj*, në shekull Dedë, O.F.M. meshtar, dhe

IV - *Mati*, në shekull Pal, *Prendushi*, O.F.M., meshtar, Ministër Provincial.

Qysh në fillim regjimi deshë t'i zhdukte personalitetet më të rëndësishme të botës katolike, domethënë ata që merreshin me predikimin dhe formimin e ndërgjegjeve të njerëzve. Për këtë arsye në mars të vitit 1945 u pushkatuan dy barinj:

V - *Lazër Shantoja*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 5 mars 1945 dhe

VI - *Ndre Zadeja* meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 25 mars 1945.

Më 4 mars 1946 u pushkatuan martirët:

VII - *Giovanni Fausti*, S.I., meshtar,



lindur në Itali, ish-Rektor i Seminarit Papnor Shqiptar në Shkodër;

VIII - *Danjel Dajani*, S.I., meshtar;

IX - *Gjon*, në shekull Kolë, *Shllaku*, O.F.M., meshtar;

X - *Mark Çuni*, student në Seminarin e Shkodrës;

XI - *Gjelosh Lulashi*, laik, dhe

XII - *Qerim Sadiku*, laik, i martuar.

Në vende dhe në kohë të ndryshme pësuan pushkatimin edhe:

XIII - *Alfons Tracki*, lindur në Slesi, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, vrarë më 18 korrik 1946;

XIV - *Fran Mirakaj*, laik, prind, vrarë në muajin shtator 1946;

XV - *Josef Marxen*, lindur në Gjermani, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, vrarë më 16 nëntor 1946;

XVI - *Luigj Prendushi*, meshtar i Arqidioqezës së Sapës, që vdiq më 24 janar 1947;

XVII - *Dedë Maçaj*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 28 mars 1947;

XVIII - *Anton Zogaj*, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, që vdiq më 9 mars 1948;

XIX - *Dedë Malaj*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 12 maj 1959;

XX - *Marin Shkurti*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq në prill 1969;

XXI - *Shtjefën Kurti*, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, që vdiq më 20 tetor 1971;

XXII - *Mikel Beltoja*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 10 shkurt 1974.

Vdiqën nën tortura apo si pasojë e keqtrajtimeve:

XXIII - *Bernardin*, në shekull Zef, *Palaj*, O.F.M., në Shkodër, në kuvendin e kthyer në burg, më 2 dhjetor 1946;

XXIV - *Serafin*, në shekull Gjon, *Koda*, O.F.M., meshtar, në burgun e Lezhës, më 11 maj 1947;

XXV - *Gjon Pantalija* S.I., rregulltar, në Shkodër, më 31 tetor 1947;

XXVI - *Mark Xhani* (*Gjani*), meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, nën tortura në Shpal në vitin 1947;

XXVII - *Dedë Plani*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, nën tortura më 30 prill 1948 në Shkodër.

Po atë vit u vranë meshtarë të tjerë të po kësaj arqidioqeze:

XXVIII - *Ejëll Deda*, në Shkodër, më 12 maj 1948;

XXIX - *Anton Muzaj*, vdiq në Shkodër në vitin 1948, si pasojë e torturave të burgimit.

XXX - *Pjetër Çuni*, në Koplik, më 31 korrik, nën tortura;

XXXI - *Lek Sirdani*, më 26 dhjetor 1948, i mbytur në gjirizin e burgut të Koplikut (Shkodër);

XXXII - *Josif Papamihali*, meshtar i Rritit greko-katolik shqiptar, më 26 tetor 1948 në Maliq, i sflitur prej punës së detyruar;

XXXIII - *Jak Bushati*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, për shkak të torturave, më 12 shtator 1949 në Lezhë;

XXXIV - *Gaspër*, në shekull Kel, *Suma*, O.F.M., më 16 prill 1950 në Shkodër;

XXXV - *Jul Bonati*, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, më 5 nëntor 1951 në Durrës;

XXXVI - *Ndoc Suma*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, më 22 prill 1958 në Pistull;

XXXVII - *Karl*, në shekull Ndue, - *Serreqi*,





O.F.M., meshtar, që pësoi një martirizim të veçantë për të mos nxjerrë sekretin e rrëfimit dhe vdiq prej mundimeve në burgun e Burrelit, më 4 prill 1954;

XXXVIII - *Marije Tuci*, e vetmja grua e këtij grupi, aspirante për jetën rregulltare mes Motrave “Bijat e Varfra të Varrëve të Shenjta të Shën Françeskut të Asizit” (Stigmatine), vdekur më 24 tetor 1950, e shpërfytyruar prej xhelatit që donte të prekte dëlirësinë e saj.

Kisha në Shqipëri, e dalë prej katakombeve, me dashuri dhe devocion mblodhi provat e martirizimit të bijve të saj, me qëllim që dëshmia e tyre e çmueshme e fesë të kontribuonte dhe të ndërtonte bashkësinë e besimtarëve në Krishtin, e cila kishte qenë e detyruar të qëndronte në heshtje për shumë kohë.

Hetimi Dioqezan mbi martirizimin u bë pranë Kuries Arqidioqezane të Shkodrës prej datës 10 nëntor 2001 deri me datën 8 dhjetor 2010. Vlefshmëria juridike e tij u njoh prej Kongregatës së Çështjes së Shenjtërve me dekret të datës 9 mars 2012. Konsultorët Teologjikë të mbledhur në Kongresin e posaçëm, më 17 dhjetor 2015, dhanë

mendimin në favor të martirizimit të tyre. Në të njëjtën mënyrë Etërit Kardinalë dhe Ipeshkvij në Seksionin e Zakonshëm të datës 19 prill 2016 njohën që këta Shërbëtorë të Hyjit u vranë për besnikërinë e tyre ndaj Krishtit dhe Kishës.

Për këtë arsye Ne, më 26 prill 2016, kemi autorizuar Kongregatën e Çështjes së Shenjtërve që të shpallë Dekretin e miratimit të martirizimit dhe më pas kemi caktuar që riti solemn i lumnimit të zhvillohej në Shkodër, në Shqipëri, me datë 5 nëntor 2016.

Në fund, sot në Shkodër për mandat tonin, Vëllai Ynë i Nderuar Angelo Amato, Kardinal i Kishës së Shenjtë Romake dhe Prefekt i Kongregatës për Çështjen e Shenjtërve, ka lexuar tekstin e Letrës Apostolike me të cilën Ne kemi regjistruar në numrin e të Lumëve Të Nderuarit Shërbëtorë të Hyjit Vinçenc Prennushi O.F.M., Arqipeshkëv i Durrësit me XXXVII Shokë, martirë të Kishës në Shqipëri: NE DUKE PRANUAR DËSHIRËN E VËLLAIT TONË ANGELO MASSAFRA, O.F.M., ARQIPESHKËV METROPOLIT I SHKODËR-PULT, SI EDHE TË VËLLEZËRVE TË TJERË TË SHUMTË NË EPISKOPAT DHE DËSHIRËN E SHUMË BESIMTARËVE, PAS KONSULTIMIT ME KONGREGATËN PËR ÇËSHTJEN E SHENJTËRVE, ME AUTORITETIN TONË APOSTOLIK DEKRETOJMË QË TË NDERUARIT

SHËRBËTORË TË HYJIT VINÇENC PRENNUSHI I URDHËRIT TË FRETËRVE MINORË, ARQIPESHKËV I DURRËSIT ME XXXVII SHOKË, MARTIRË TË KISHËN NË SHQIPËRI, QË ME SHPIRT HEROIK E MBAJTËN NDEZUR LLAMBËN E FESË NË KOHËN E ERRËT TË PËRNDJEKJES, TASH E PRAPA TË QUHEN TË LUMË DHE QË FESTA E TYRE TË KREMTOHET ÇDO VIT MË 5 NËNTOR, NË VENDET DHE NË MËNYRAT E PËRCAKTUARA PREJ TË DREJTËS KANONIKE. NË EMËR TË ATIT, E TË BIRIT E TË SHPIRTIT SHENJT.

Pra, ne me këtë rast gëzojmë së bashku me Kishën në Shqipëri për dëshminë e fortë të besnikërisë ndaj Krishtit të këtyre të Lumëve, mes të cilëve nderojmë shumë barinj dhe rregulltarë të zellshëm, po ashtu edhe laikë bujarë të gatshëm për t'u flijuar. Dhe kjo që dekretojmë, duam dhe caktojmë që të hyjë në fuqi menjëherë, pavarësisht çfarëdo gjëje që mund të jetë kundër.

Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, nën unazën e Peshkatarit, më 5 nëntor 2016, i katërti i pontifikatit tonë.

Kard. Pietro Parolin
Sekretar Shteti

SFIDA KULTURORE E VIDEO-LOJËRAVE GIOVANNI CUSSI S. I.

Video-lojërat : një ndihmesë apo një pengesë në të nxënë ?

Tema e lojës, në dimensionet e saj serioze apo sipërfaqësore, në të ndihmuarit apo në të shmangurit është mjaft e debatuar përgjatë kohës, shumë më përpara shfaqjes së video-lojërave. Këto na riprodhojnë një nivel më kompleks të çështjes. Cilido qoftë përfundimi, studimet më rigorozë bien dakord në atë që të pranojnë tërheqjen e kujtudo, që ka luajtur me to, dhe në atë se si mund të favorizohet motivimi; natyrisht për qëllimet më të ndryshme dhe sfiduese.

Disa mund të kenë pyetur si është e mundur që një djalë apo një adoleshent, i cili e ka të pamundur që të përqendrohet përballë një teksti epik, poezie,

stimulojnë procesin e të kuptuarit. 1) Studenti duhet të jetë i *inkurajuar*; që të provojë edhe pse ka arsye të forta, që të ketë frikë provën. 2) Studenti duhet të jetë i inkurajuar, që të provojë *në të gjitha mënyrat*, edhe nëse motivimi fillestarë është minimal. 3) Studenti duhet që të arrijë *ndonjë sukses domethënës*, suksesi pa lodhje nuk është e dobishme, e të lodhesh pa arritur asnjë rezultat sado të vogël, është njëlloj e padobishme. Duken gjëra shumë të thjeshta në pamje.

Zgjidhjet negative të video-lojërave

Fuqia e tërheqjes nga video-lojërat, mund të jetë edhe negative dhe varet nga mekanizmi i varësisë patologjike individuale. Me këtë shprehje kuptohet

pamundësia, gjithnjë e më pushtuese, për të parashikuar aspekte të rëndësishme të jetës (ushqimi, gjumi, studimi, lidhjet), duke shkaktuar një dëm për dimensionet thelbësore të një personi (shëndeti, përqendrimi, humori, agresiviteti, interesat, memoria, kreativiteti, lidhjet e rëndësishme), dhe një humbje kohe, pasi kalohen 31 orët javore. Sa i takon adoleshentëve, e gjitha kjo ka çuar në uljen e nivelit shkollor. Ato pohojnë se pasi kanë kaluar dy orë përpara televizorit, ato nuk kanë dëshirë për të bërë asgjë.



historie apo që nuk mund të zgjidhë një ushtrim matematikorë, të një niveli mesatar, mundet nga ana tjetër, që të rrijë përpara një kompjuteri apo tableti për të zgjidhur detyra angazhuese, që shpesh kanë të bëjnë me të njëjtat disiplina të trajtuara në klasë. Të përfundosh një video-lojë të një vështirësie mesatare, kërkon, për ato që janë ekspert, nga 30-100 orë, së bashku me njohje të specializuara; për atë i cili është fillestarë numri i orëve shtohet. Megjithatë video-lojërat shiten në miliona kopje, për përdorues të të gjitha moshave, numër i cili vjen gjithnjë në rritje.

James Gee, një profesor i gjuhësisë, me një CV të pasur akademike drejtuar kësaj teme, e vëren këtë element. Veçanërisht dallon 3 aspekte, që mund të

Sa i takon të rinjve, ku numri i pjesëmarrjes (në mësim) ulet nga 43% te 11-12 –vjeçarët; në 9 % te 17-18- vjeçarët. Kërkimi tregon një influencë të veçantë në 5 zona të personalitetit, që janë: pushimi, obeziteti, duhani, alkooli, abuzimet. Duke menduar se sa i pakujdesshëm është adoleshenti në këto pika, ne duhet të shqetësohemi akoma më shumë: perceptohet gjithnjë e më pak ajo që po ndodh. Duket që ky është motivi që për ato që janë të varur nga filmat apo programet e dhunshme, kur asistojnë në skena të dhunës reale, kuptojnë se sa e rëndë është situata. Vihet re një përshtatje e shkurtër i atij që është i dhënë të shikojë skena të tilla, që t'i shmanget ndjenjave të tjera, si: empatia, butësia,

mirëkuptimi, duke e bërë këtë njeri indiferent, gjë që është qendra e sjelljeve shkatërruese.

Çfarë çon te të qenit i varur?

Video-lojërat kanë një ndikim të madh në zonat e mbulojës cerebrale, duke modifikuar ashtu si ndodh kur përdoren substanca të drogës. Përdorimi i gjatë tenton të rregullojë zonën e majtë, që lidhet me ndjenjën e pëlqimit, të kontrollit dhe të mundësisë për të marrë vendime, të gjitha zakone që rezultojnë thelbësore për të na çuar të përfundojmë një video-lojë me sukses.

Ky stimulim mund të influencojë sipas mënyrës së tij, zakonet e përditshme, perceptimet, njohjen e objekteve, aftësinë për të memorizuar dhe bërë parashikime, kujdesin, vëmendjen në punë, perceptimin e hapësirës. Kush luan më shumë sesa 9 orë në javë, shfaq një volum më të lartë të lëndës grihe në hemisferën e majtë, me vazhdimin e të ndjerit të kënaqësisë dhe të rrezikut, në varësi të aktivitetit reflektiv dhe vlerësues që bëjmë në fund.

Këto të dhëna tregojnë kompleksitetin e problemit dhe aspektet e shumta që na shfaqen pas varësisë nga loja. Duhet theksuar që shumëllojshmëria e lojërave ka efekte të ndryshme mbi lëvoren cerebrale, por gjithsesi regjistron ndryshime të rëndësishme. Riprodhimi i video-lojërave të dhunshme, luan një rol kohë-gjatë mbi funksionimin e trurit.

Natyrisht, numri i orëve të kaluara duke luajtur është një tregues i rëndësishëm për një diagnozë të një varësie të mundshme, veçanërisht nëse kërkohet në lojë një kompensim të mungesave, madje edhe të mëdha, të fushave të tjera të jetës. Keith Bakker, themelues dhe drejtues i qendrës Smith & Jones, Amsterdam, që merret me probleme që lidhen me përdorimin e pandreqshëm të video-lojërave, tregon se 80% e të rinjve, që i kemi pasur në klinikën tonë, ishin viktimë të bullizmit dhe izoloheshin në shkollë. Shumë nga problemet që tregonin, mund të zgjidheshin me praktika të vjetra bashkëkohore. Ajo për të cilën kanë më shumë nevojë janë *prindërit* dhe *mësuesit* e tyre: ky është një problem social.

Nga video-lojëra te video-luajtësi

Këto përfundime sjellin gjëra, që i patëm marrë parasysh në një kah tjetër, bazuar në varësinë e zakonshme nga interneti: problemet e dalluara reflektojnë atë jetë *off line*, dhe pikërisht nga ky krah duhet të përballohet varësia. Shumë nga ato, që përfundojnë në kurthet e ueb-it, manifestojnë

problematika precize në jetën reale, por mbi të gjitha sepse janë rritur në familje të dhunshme, apo aty ku modelet e referimit janë lidhur me arritjen e suksesit me çdolloj mjeti dhe ku tjetri është parë me syrin e një rivali, që duhet eliminuar, arrijmë në përfundimin që: të rinjtë e dhunshëm nuk janë të tillë thjesht sepse përdorin video-lojërat e dhunshme.

Kjo është ajo që rrjedh nga një studim i kryer më 2011, i kërkuar nga SHBA-ja, për të pranuar lidhjet mes sjelljeve të dhunshme me programet apo lojërat e tilla. Përfundimet e studimit nuk gjenin lidhje të rëndësishme mes dy aspekteve, të tilla sa për të dalë në përfundimin shkak-pasojë. Elementet më të dallueshme lidheshin me situatën e prejardhjes (veçanërisht ambienti familjar dhe lidhjet) dhe me psiko-dinamikën e përgjithshme të subjekteve, si tendenca ndaj depresionit dhe sjellje asociale. Prania e këtyre elementeve nënkuptonte mundësinë për shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Një provë kundërshtuese vjen nga fakti që problematikën gjenden edhe në persona të dhunshëm, që nuk përdorin video-lojërat; nga ana tjetër përqindja e lojtarëve që çojnë në dhunë, është e ulur, rreth 10%.

Studime të shumta, si ai i kuruar nga universiteti i Rochesterit, mbi 1300 lojtarë të moshave 18-43 vjeçare, kanë pohuar se prirja ndaj varësisë nga ana e lojtarëve të regjur nuk është e lidhur me lojën, por me çështje të personalitetit: veçanërisht, të një ndjenje të frustimit të përhapur dhe pamundësie për të shijuar jetën ordinere. Kur këto aspekte u morën në konsideratë dhe u përballuan në karrigen terapeutike, u tregua dhe ridimensionimi i lidhjes me lojën.

Konkluzione të ngjashme u shtuan edhe nga një Konventë, e kuruar nga Universiteti i Kembrixhit, 2011. Një nga kërkuesit tregonte veçanërisht, që të kërkuarit e zgjidhjeve duke ndaluar përdorimin e lojërave, është sikur të kërkosh ligje, të cilat ndalojnë supozimin e tepërt për ushqimet e pashëndetshme, për të luftuar obezitetin apo bullizmin. Nëse ju duket se një fëmijë apo një person i dashur luan në një mënyrë obsesive video-lojërat, mos shkoni direkt në konkluzionin se lojërat janë bazat e palumturisë së tyre. Flisni me to dhe mundohuni të kuptoni cilat janë ato që i mungojnë jetës së tyre dhe nëse mundeni, ndihmohuni që ta kalojnë atë problem.

Dimensioni edukativ dhe social i video-lojërave

Vetë video-lojërat mund të na bëhen një ndihmë

në këtë drejtim. Disa nga ato, të quajtura “serious game” (lojëra të tipit edukativ), promovojnë altruizmin dhe zhvillimin, konsistojnë për të rinjohur mundësitë e tyre të brendshme, për t'i vënë në dispozicion të të tjerëve.

Food Force është njëra nga këto lojëra, të krijuara në 2005 nga programi botëror i SHBA-së (PAM). Kush merr pjesë mund të kontribuojë në një mënyrë konkrete duke ndihmuar qytete në zhvillim: “Lojëtarët duhet të përpiqen, në misionet të ndryshme me qëllim që ushqimin ta dërgojnë në një qytet, i cili e vuan urinë, duke i ndihmuar që të marrin veten. Njëkohësisht, ato mësojnë se çfarë është uria në jetën e përditshme dhe cila është puna e PAM-së për ta parandaluar”. Një lojë tjetër është *Freerice*, një pyetësorë, që ndihmon në zhvillimin e logjikës, duke konsistuar të dhuruarit e ushqimit për popullsinë e varfër.

Këto janë aktivitete të cilat zhvillojnë vetëvlerësimin e atyre që e praktikojnë (pasi kuptohet që je i dobishëm dhe i rëndësishëm për të tjerët), dhe njëkohësisht ndërtojnë një kuadro problemesh me objekte të lojës, në varësi të stereotipeve sipërfaqësore. Që të mund t'i hedhësh një sy anës tjetër të murit dhe të hysh në kompleksitetin mund të shfaqen fantazma dhe frikëra ireale, të cilat shpeshherë janë aspekti më i madh i problemit. Për të pasur një kompetencë të tillë, ne na duhet të dialogojmë me të rinjtë e dhunshëm nuk janë të tillë thjesht sepse përdorin video-lojërat e dhunshme të rinjtë mbi këtë temë, dhe të përpiqemi t'i drejtojmë drejt pasioneve, të cilat mund të stimulojnë në të vërtetë mundësitë dhe interesat e tyre.

Kjo dhe lojëra të tjera, mund të jenë individualizuar dhe zgjedhur falë revistave të specializuara, gjithnjë e më të shumta në numër, më së shumti në gjuhë angleze, si: *Games Research Journals, Games and Culture*, .

Dimensionin etik

Një tjetër argument i rëndësishëm në lidhje me video-lojërat është mundësia për t'i kuptuar problemet e mëdha të aktualitetit në aspektin etik. E kemi theksuar problemin e urisë në botë, dhe ndihma e qyteteve në zhvillim. Disa lojëra kanë si objekt të tyre luftën. Në të kaluarën ajo është celebruar shpeshherë në literatura në aspektin e burrërisë, e rëndësishme kjo për zhvillimin.

Duke shikuar në konfliktet “një higjienë për botën”, ishte një nga motivet që e çuan Evropën në masakrim, duke shkaktuar dy luftëra botërore, pa asnjë shkak bindës. Steriotipet kulturore janë më të

fortë kur janë më të fshehur, të vështira për t'u identifikuar dhe korrigjuar, pasi shërbejnë si një levë për imagjinatën e mbi emocionet, që kanë një lidhje të fortë me ndërgjegjen. Për këtë arsye stereotipet gjejnë në Letërsi dhe në lojë një kamp të fortë aplikacionesh. Por edhe të korrigjimit.

Në panoramën e ofruar të video-lojërave on line, janë disa që sigurisht favorizojnë këtë version “romantik” të luftës dhe të dhunës, me një gjuajtje të thjeshtë drejt kundërshtarit, ose zgjedhja klasike duke hequr “të keqen”, duke eliminuar “të këqijtë”.

Është i rëndësishëm fakti që lojërat janë përdorur si një formë e rekrutimit në ushtri. Në lojëra ekziston një link, që lejojnë që të lidhen me një sit, që na shërben për të eksploruar mundësitë për të kontaktuar një rekrut.

Në këtë aspekt, video-lojërat evidentojnë një aspekt thelbësor të njohjes njerëzore, fatkeqësisht pak të trajtuar: imagjinata mund të plazmojë në mënyrë thelbësore kriteret në të cilat lidhet realiteti, duke i dhënë zë frikërave apo shpresave që shpesh bëjnë diferencën në proceset e vlerësimit. Filmat e suksesshëm të USA, në fund të shek. XX, ishin të llojit katastrofik. Disa të tjerë tregojnë se si virtualja, mundësitë e pafundme teknologjike, konsistojnë në projektimin e së ardhmes dhe në modifikimin e saj, falë qëllimeve speciale të shërbimeve sekrete, që kanë mundësi për të ndërhyrë në çdo lloj mundësie, në emër të së mirës të përgjithshme. Këto filma komunikojnë një imazh shumë sugestionues dhe të nevojshëm për të legjitimuar luftëra dhe ndërhyrjeve ushtarake.

Megjithatë ka video-lojëra, të cilat tregojnë në një mënyrë të vlefshme, absurditetin dhe panevojshmërinë e luftës. Bëhet fjalë për produkte, që e shikojnë sërish në mënyrë kritike përshkrimin e konfliktit në mënyrën e një aventure tërheqëse dhe heroike, e mbi të gjitha tregojnë zhvillimin etik të problemeve të tilla. Kjo ndodh në lojërat si: *Medal of Honor: Pacific Assault*, që inskenon ataktin e Pearl Harbor, më 7 dhjetor 1941; ose ajo e “*Salvate il soldato Ryan*”.

Në këto lojëra personazhet janë të përfshirë në luftime të dhunshme, të cilat nuk ofrojnë asgjë të bukur apo tërheqëse, po ku përfshijnë barbarinë dhe mizorinë nga të dyja palët.

Programe të tilla mund të stimulojnë disa zakone thelbësore, në nivelin njohës dhe moral, si p.sh.: empatinë. Kjo sjellje lind nga një edukim i imagjinatës dhe është pika e hyrjes te ndjeshmëria morale. Duke u bërë të vetëdijshëm për brishtësinë, është e mundur që t'i lëmë vend ndjenjave dhe sjelljeve që lidhen me dhembshurinë, brishtësinë, të kuptuarin e tjetrit, duke i konsideruar problemet e

tjetrit, jo të largëta me ty.

Duke marrë pjesë në një lojë, është e rëndësishme që të tematizojmë të tilla zakone, që janë thelbësore për edukimin dhe nivelin njohës, duke arritur një ndërstadet më të larta të zhvillimit moral, atë të cilën Kohlberg e quan role-takig, pra mundësia empatike, që të mund të vendosesh në anën e tjetrit, duke kuptuar se cila është e mira e tij, duke shikuar në një pikë të tillë, kritere të vlerësimit, të cilat deri në atë moment nuk i shikojë.

Nga këtu video-lojërat mund të marrin rëndësi të madhe në aspektin pedagogjik: “Natyra e së mirës dhe së keqes, kriteret e vlerësimit moral, zhvillimi empatik, vlerat e tolerancës, e të respektit të tjetrit, janë të gjitha aspekte të një impakti të madh dhe të një rëndësie të madhe në fushën e një edukimi moral: që video-lojërat të kontribuojnë për të krijuar një laborator të tërë etik”.

Reflektimi, në anën e tij, ndihmon që të ndërjegjësohemi për aspekte të tjera të rëndësishme, ekzistenciale, siç janë lidhjet, mundësitë për t'i kërkuar ndihmë personave kompetent dhe bashkëveprimi me praktika linguistike, të imazhit dhe të shkrimit; ato të cilat Gee i quan “hapësira të prirjes”; nga ana tjetër të stimuluar për të kuptuarit, bashkëpunimin, bashkëndarjen dhe respektin reciprok, tejet të rëndësishme për realizimin e projekteve dhe punë që do të rezultonin të paarrtshme dhe për njeriun më gjenial.

Edhe televizori është i nevojshëm për rritjen njohëse të fëmijëve, nëse e shikojnë në një mënyrë të përqendruar, ashtu ndodh kur të rriturit diskutojnë me fëmijët mbi atë për të cilën po shikojnë. Nëse fëmijët shikojnë diçka në televizor në mënyrë pasive, atëherë kjo gjë nuk e ndihmon atë. Është e dukshme që fëmijët janë lindur në një kulturë të dhunës dhe abuzimit, kuptohet që ato zgjedhin televizorin, për të mos folur mbi ato çka e rrethojnë në jetën reale, si një ushqim për zemërimin dhe paorientimin e tyre.

Aktualiteti i të mësuarit biblik

Video-lojërat riprezantojnë çështjet e urtësisë së përhershme, duke rikonformuar aktualitetin e dilemës së treguar që në gjenezë: të jetosh në plotësi do të thotë të fitosh fuqi, sukses, të jesh i pavdekshëm (me fjalë të tjera, të jesh Zoti), ose të vazhdosh të tillë plotësi duke i pranuar kushtet e tua, të cilat të çojnë në brishtësi, në limit, në ndërjegjësimin e kohës së limituar në dispozicion dhe nevojës për të bashkëpunuar që të realizosh një objektiv të përbashkët? Të dyja mundësitë janë të

pranishme në shumë video-lojëra. Është interesante, që disa nga ato, si ato të sipërpërmendura, i qëndrojnë domosdoshmërisë së të drejtuarit të një figurë “e shenjtë”, për të kërkuar ndihmë apo mbrojtje, ose një guidë në udhëtim.

Është bukur që të vihet re se si figura e meshtarit, në temën e lojërave *on line* lidhet me shumë me çështjen e jetës e të vdekjes: “Kur në *The Sims*, lojtari i bën zgjedhjet e veta mbi personazhet, mbi lidhjet e tyre e mbi jetën e tyre (shpeshherë lojtarët përdorin si personazhe loje, njerëz real, miqtë e tyre), mund të përfshihen në jetët e tyre, pikëvështrime që deri në atë moment nuk i kushtonte rëndësi, kurse tani dëshiron që të reflektojë mbi to”.

Për të theksuar, të gjitha këto, mund të përbëjnë një çështje efektive të konfrontimit me problematika thelbësore të ekzistencës, për ato si të rinjtë, por jo vetëm, për një frekuentues ngulmues të rrjetit. Tema sigurisht që është komplekse, por edhe intriguese, dhe na çon te prania e së shenjtës dhe të kërimit të shenjtë, që karakterizon edhe botën digjitale. Sfidat e karrigeve pastorale.

Dimensioni i dijes, në kohën e uebit, nuk ka ardhur më pak. Në 2007 pyetja që është bërë më shpesh në google, ishte: “Kush është Zoti?”; ajo e Jezusit figuronte në vendin e katërt. Në 2010 vizituesit e siteve besimtare arrinin një miliard e gjysmë.

Të fitosh familjaritet me botën e uebit, mund të riprezantojë në mënyrë të gjallë dhe aktuale çështje, të cilat gjithnjë kryesojnë edhe në format, me sa duket, më origjinale dhe argëtuese.

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “La civiltà cattolica”, 2019.



Don Nosh GJOLAJ

KRIZA E IDENTITETIT SI MASHKULL DHE SI BABË

(Pjesa e dytë)

b) Tipi dhe roli i babës gjatë shoqërisë antike dhe asaj mesjetare

Në shoqërinë e antikës dhe asaj mesjetës, në të cilën shoqëri ishte shumica e popullatës fshatare që u merrte me bujqësi dhe blegtori. Familja e tillë janë varur prej tokës. Prej kësaj edhe nevoja për familje të mëdha dhe të forta, për ndryshe i ka shkelë koha dhe nuk kanë mundur të mbijetojnë. Atëherë është e kuptueshëm për këtë shoqëri, që është e organizuar në bashkësi të mëdha familjare dhe të lidhur ngushtë me klanin ose fisin që i përkasin. Familjet e tilla i quheshin "consortium", në shoqërinë romake (Andree Michel, "Fonctions et structur de la famille", në: Cahiers internationaux de sociologie 28 (1960), 113-135).

Funksioni primar i kësaj bashkësisë familjare ishte ekonomik dhe religjioz. Consortium-i ishte pronar i tokës dhe mjeteve e përpunimit të tokës. Kujdesi dhe mirëmbajtja e pronësisë ishte para kusht për ekzistencë dhe siguri e një familjes. Anëtari më i aftë ose më i moshuari i kësaj bashkësisë familjare ishte në krye të bashkësisë -

konsorsiumit. Pas vdekjes së tij udhëheqja e bashkësisë nuk e trashëgon i biri i tij, por vëllezërit, ose më i afti. Familja e tillë në të njëjtën kohë ishte edhe bashkësi ose grup religjioz. Ku i kishin hyjnitë e veta specifike të familjes dhe ritualet e veta.

Të ngjashme familje i takojmë edhe në mesjetë

E kuptueshme është, se në bashkësi e mëdha familjare, është edhe struktura e mbrëmshme e familjes që ndahet në njësi më të vogla të familjes, siç fjala vjen, burri, gruaja dhe fëmija e tyre. Por autonomia dhe identiteti i këtyre njësive më të vogël ishin të zbetë dhe nën hijen e autoritetit të udhëheqësit së familjes së madhe, siç bie fjala, babamadhë dhe nëna e magjes (bukës). Në familjet e tilla gjithçka është e nënshtruar qëllimeve të përbashkëta të bashkësisë. Autoriteti kryesor ishte udhëheq i bashkësisë, i cili e dirigjon dhe jep urdhëresat në miratim me njerëzit e rangut të tij, por dinë të këshillohet edhe me vëllezër dhe nipat e vet për ndonjë vendim të rëndësishëm. Ashtu ai e krijon



ritmin e jetës dhe të punës, frymëzon dhe kurajën, përcakton mënyrën e ushqimit, ashtu ndikon në edukatë dhe në aktivitet e tjera. Në rrethanat e tilla roli i babës në këtë tip të organizimit të shoqërisë nuk ishte i madh, por shumë i zbetë. Por baba bashkë me të tjerët i siguron mjetet për jetën e bashkësisë ku ndahen bashkërisht në njësit e vogla përbrenda familjes së madhe. Roli i babës dhe sjellja e tij ishte i definuar sipas normave të bashkësisë, që ishin të përbashkëta. Ashtu ishte i definuar edhe norma e raportit burrit ndaj bashkëshortes dhe ndaj fëmijës. Nuk kishte ai ndonjë aftësi specifike dhe ndikim në edukatën e fëmijës, jashtë normave të jetës së përbashkët në bashkësi. Funksioni i babës ishte në rendin e parë puna për mirëmbajtjen e familjes, sot i themi ekonom, por në rastet e diskriminimit të gruas dhe fëmijëve të vet, atëherë ai ishte edhe mbrojtësi i tyre.

Zhvillimi dhe zanafilla e stadiumit të parë të familjes ishte tipit agrar. Ndërsa faza e dytë, ishte ndarja e bashkësive të mëdha, në familjet të quajtura "familja nukleare". Në historinë e vonshme të Romës, prej consortium do të krijohen familjet e quajtura "domus", ashtu vlen edhe prej familjeve të mesjetës siç ishin zadrugat te populli sllavë do të krijohen familjet e vogla. Edhe këtu luanë rolin kryesor faktori ekonomi.

Për një periudhë do të takohemi me tipin e familjes para industriale. Karakteristika tipike e kësaj familjes ishte afërsia e punës dhe të banimit. Aty kishte mundësi të aktualizohet si atësia e babës ashtu edhe të nënës me afërsinë e vet fizike dhe psikike. Si meshkujt ashtu edhe femrat janë të pranishëm në bashkëpunimin e dy sferave, edhe pse ishte një farë distance në role të dame. Gruaja-nënë ishte me shumë fëmijë, dhe si e tillë ishte ngushtë e lidhur me shtëpi. Por gjatë kohës së punës në bujqësi, ajo ishte edhe jashtë shtëpie në fushë duke punuar.

Baba e kishte pushtetin e fortë në duart e veta dhe roli i tij në familjet ishte kryesisht nën mbikëqyrjen e tij. Autoritetin e vet e themelonte në faktin, se toka në të cilën jeton është pronë e babës së tij. Aty mbretëronin edhe rregulloret e ashpra të babës, si kryet e familjes, i cili jep urdhëresa dhe këshilla se si duhet të sjellët gruaja dhe fëmija, në jetën e përditshme. Ai i diktonte edhe raportin e sjelljes ndaj tij si babë, dhe i ndatë rolet, se kush çka do të kryejnë.

Burri ishte më së pari zot (shëf) i gruas së vet, dhe më së paku mikë dhe partner i saj. Edukata ishte në duart e gruas, por baba herë pas herët intervenon me masat e ashpra ndaj fëmijës ose gruas në rastet e

rënda. Burri nuk bënë dhe është turp t'i tregojë ndjenjat e veta gruas, posaçërisht publikisht. Ai e titullon gruan e vet jo me emër por zakonisht ti, hej, dëgjove he! Atëherë nuk është e çuditshëm se baba i tillë, që nuk do t'i tregojë ndjenjat e butësisë as ndaj fëmijës së vet, se gjoja nuk i paska hije mashkullit! Baba i tipit të tillë zakonisht nuk lozë me fëmijën e vet, sepse ai ka ndonjë punë tjera më të rëndësishme. Mashkulli i tipit të tillë si babë, në mënyrë të vetëdijshëm dhe me plotë përgjegjësi ai do të kujdesohet për t'i siguruar mjetet materiale dhe mirëmbajtjen e familjes. Ai mundohet që të zhvillohen fëmija sa më normal. Por tipi i babës së tillë nuk ka kohë që familja ta përfjetojnë ngrohësin e tij si babë. Ashtu fëmijës i mungon identiteti i mashkullit dhe në jetë do të jetë i çalët dhe i frustruar!

c) Roli dhe tipi i babës në shoqërinë industriale

Atu ka mesi i shekullit të 19-të, me fillimin e industrisë dhe të urbanizmit, fillon me u ndërruar edhe struktura e familjes, me të edhe roli dhe tipi i babës. Në kohën e industrializimit shihet shumë qartë kalimi i familjes prej tri gjeneratave në dy-gjenerata. Madje fillon të zvogëlohet vdekshmëria e fëmijës dhe periudha e jetës së njeriut në përgjithësi filloj të zgjatet..

Dallimet kryesor mes tipit të familjes para industrial dhe atë industrial është në vendin e punës dhe banesa. Në këtë të fundit banesa është e ndamë prej vendit të punës. Artizanati dhe bujqësia lihen pas dore, fuqia e re punëtore shkon në fabrika. Një atmosferë e tillë ndikon shumë edhe në raportin mashkull - femër. Në fazën fillestar të industrisë ishte orari i punës pothuaj tërë dita. Meshkujt praktikisht e kalojnë tani tërë kohën në punë, nëpër fabrika të ndryshme, që do të thotë jashtë familjes. Ndërsa gruaja merret me familje. Ashtu meshkujt praktikisht e humbin detyrën e vet familjar, si ndaj gruas ashtu edhe ndaj fëmijës. Ai duke kaluar kohën e shumët në "shoqërinë" e makinave të ftohta dhe me punë të rënda, ashtu fillon të zhvillohet në mashkull-babë një farë vetëdije e re të tipit industrial, që ai vet është materializua - është bërë një pjesë e makinës. Ai atëherë dashtë e pa dashtë ngecë në zhvillimin e gjallë njerëzor, në botën humane me miqtë dhe shokë në shoqërinë e përditshme. Ajo shoqëri, që është vetëm në duart e gruas, aty nuk mund më të flitet për rolin e babës (mashkullit) në familje. Në të vërtetë baba është mysafir në shtëpinë dhe në familjen e vet, i cili i viziton familjen dhe shtëpinë gjatë natës dhe të

dielave. Edhe këtë radhë ai është shumë i lodhur dhe fizikisht dhe shpirtërisht i shterur edhe e shoqëron njëfarë ndjeshmërie që e nxitë në hidhërim të shpejt, dhe e humbë baraspeshën e normales apo drejtpeshimin. Prej tij atëherë nuk mund të pritët shumë. Mbetet vetëm marrëveshja për mbi shpenzime, çka dhe ku me i shpenzuar paranë që ai i fiton me djersë. Gruaja ka dëshirë për ta lajmëruar për situatën në familje dhe gjendjen e saj, fatkeqësisht baba nuk ka duresë ta dëgjojë dhe reagon ashpër në gabimet e fëmijëve. Për këtë

zëvendëson roboti.

Gjersa familja është stabilizuar në dy gjenerata njerëzve (prindërit dhe fëmija). Distanca në mes banesës ku banon familja dhe vendi i punës ku punon është shumë më i madh. Medicina ja ka arrit ta zgjasin jetën e njeriut dhe vdekshmëria e fëmijës është zvogëluar dukshëm, por numri i fëmijëve ka ra dukshëm (1 ose 2). Dukshëm është shkurtuar edhe koha e punës, që sot është minimumi 35 orë në javë, që zgjat pesë ditët e javës. Tipi i familjes së dikurshëm gradualisht është në zhdukje, ose



paradoks themi me nocionin e quajtur "matriarkati i patriarkatit". Sepse ekzistenca e familjes varet prej babës që punon, gjersa të gjitha punët e tjera të familjes i udhëheq gruaja.

2. Shoqëria moderne

Me nocionin modern e kuptojmë at shoqërinë e Perëndimit, që e quajmë edhe shoqëria pos industriale. Në shumicën e rasteve masa e madhe e punëtorisë është e punësuar në sektorët e ndryshme të shërbesave të ndryshme, siç janë bankat, shkollat, tregtia, agjencia etj. dhe dita-ditës pakësohet numri i punëtorëve në fabrika, të cilët i

dukshëm ka ndërruar fizionominë e vet. Shkolla, sporti, kultura, religjioni dhe grupet karitative (bamirësie) e kanë marr peshën kryesor në socializmin e fëmijës.

Modeli tipik i familjes në shoqërinë moderne përbëhet prej babës dhe nënës dhe një ose dy fëmijë, radhe është i treti fëmijë. Mesatarja e fëmijëve në botën e Perëndimit është 1,5 deri 1,8 fëmijë. Si baba ashtu edhe nëna e fëmijës janë të punësuar. Gjyshi dhe gjyshja jetojnë damë, (ndoshta në shtëpi e pleqve). Shenjat karakteristike të familjes moderne është luhatja e saj, që i ka këmbët prej qelqit (xhamit). Familja nuk është më bashkësia ekonomike, siç ishte dikur. Por ajo sot në

përgjithësi as gjë nuk prodhon por vetëm shpenzon.

Edukata e fëmijës është besuar të tjerëve. Nëna më së shumti do të qëndrojnë një vit me foshnjën e vet pas lindjes. Mandej foshnjën (fëmijën) do ta besoj të tjerëve: rritje dhe edukatën e tij. Pastaj fëmijën do ta dërgoj në çerdhe dhe në foshnjore dhe në fund është dëshira e prindërit që të shkollohet fëmija i tyre në shkolla private. Ashtu dukshëm reduktohet roli i babës dhe i nënës në lëmin edukative, por u mbetet vetëm organizimi dhe kontrolli, ose mbikëqyrja financimi, për zhvillimin i fëmijës së vet.

Statistika dëshmon se martesë dhe familjet moderne i kanë themelin e cekët, dhe si të tilla ato dështojnë shumë shpejt, çka flet, se çdo e treta martesë ndahet -(divorci).

Në familjet e sotme ndikon edhe fakti se fëmija, relativisht herët pavarësohen prej gjirit familjar, dhe bashkëshortit jetojnë pa fëmijë. Përpos obligimeve të martesës prindërit janë të ngarkuar edhe me obligime tjera siç bie fjala me nënën plakë, babën, dajën, tezen, vjehrrën etj., ose me ndonjë individ të sëmurë nga gjiri i familjes së gjerë, që duhet të kujdesohen për të.

Një tjetër faktor prapë ndikon në familjen e sotme, dhe ajo është orvatja për ruajtje e vendit të punës, ashtu ata duhet pa ndërpre me krye kurse të reja, duke u specializuar në novitetet që shpiken dita-ditës. Këto janë disa faktor që e kushtëzojnë sot familjen moderne.

Roli i babës në këtë familje është zbe. Ta paramendojmë një Italian, Gjerman apo Francez. Familja i tij jeton në një shtëpi të rregulluar jashtë qytetit. Ndërsa koha e punës, që e kryen në zyre është tetorëshi, që fillon prej 9 deri 17/h. Dhe gjatë pesë ditë e javës. Atij i duhet të zgjohet ka ora 7 të mëngjesit. Bënë një dush, dhe kryen nevojat higjienike të mëngjesit, mëngjesi me një kafe ose çaj. Niset në punë me automobil dhe trafiku i mëngjesit është shumë i dendur dhe udhëton më se një orë deri në parkingun e vendit të punës. Në ora 9 ai ia fillon punës në zyrën e vet, aty e pret shefi i tij dhe koleget dhe shoqet e punës. Ndërsa problemet dhe shqetësimet familjar edhe të gjitha kujdeset tjera duhet me i lërë pas derës së punës, dhe tani me u koncentruar në punën e firmës, të bankës ose të agjencisë. Sepse këtu mbretëron tregu i lirë dhe konkurrencat e shumta. Për ndryshe lehtë mund të humbet puna në tregun e lirë dhe firmat falimentojnë gjatë natës! Aty ka 12,30 deri 13/h është koha e pushimi, që zakonisht e kalon në kafe ose në bar, në bisedë me kolegë ose shoqe të punës. Pastaj prapë vazhdimi i punës deri në orën 17/h.

Atëherë prapë e ripërtëri trafikun e pasdites që është ashtu i dendur si ai i mëngjesit dhe pas një orë arrin te shtëpia. Një pjesë të motmotit shkon natën në punë dhe kthehet natën në shtëpi. I cili tani është i lodhur dhe i shterur psikik dhe fizikisht, që mëmësi pret që të gjuhet në kauç ku e ndez televizorin dhe lexon gazetën, deri sa gruaja nuk i vjen darka e begatshme, sepse drekën e ngrënë në shpejtësi. Kuptohet pas darkës është koha e lajmet televizive. Pas lajmeve rastësisht mund me qenë ndonjë lojë topit, sport ose tribuna politike ose ndonjë film. Pas 22/h zakonisht shkon për të pushuar, që prapë të nesërmen të zgjohet në ora 7/h të mëngjesit.

Në një ditë aq dinamike e bënë babën / mashkullin/ të tendosur dhe të paafte për ndonjë dialog me gruan. Dhe mos flasim se ai fare nuk ka kohë as për gruan as për fëmijët. Në qoftë se edhe bashkëshortja punon, e cila e ka pak a shumë të njëjtin ritëm të punës që e përshkruam më lartë, por përpos punës që e bënë gruaja te shtëpia e pretë edhe punët e amvisjes. Aq më tepër rritet tensioni mes çiftit martesor, që shtëpinë e kanë bërë bujtinë ose pushimore dhe nuk është më aty vatra e ngrohtësisë familjare! Tani ka mbetur edhe fund java apo vikendi për ta shfrytëzuar së bashku! Në shumicën e rasteve, çifti modern të shtunën flenë më gjatë për të pushuar. Gruas i duhet t'i plotësojë punët e mbetur, që deri tani nuk iu ka ardhur apo rendi për t'i krye. Gjithashtu i duhet me dalë në treg, për të blerë ushqimin rezervë për tërë javën. Ndërsa fëmija, ditën e lirë e shfrytëzon për me dalë me moshataret e vet, ose në ndonjë aktivitet tjetër sportive. Gjithashtu edhe ditën e diel, flenë më gjatë, dhe përgatiten dhe shkojnë në kishë. Bashkëshortja e përgatit drekën solemn që dëshirohet që të jetë tërë familja e bashkuar për rreth tryezës. Aty mund të krijohet një farë ndenje, se e kanë një farë frymë të përbashkët dhe përgjegjësin e ndërsjellët. Aty mund baba me treguar identitetin e vet, por fatkeqësisht ai nuk ka duresë me përjetuar tjetrin, por tani shfrytëzon rastin superioritetit dhe fillon të ligjëroj, këshilla dhe norma, dhe kërkon llogarit për obligimet e pakryera. Me këto gjeste e vet ai e prish atmosferën festive të dielës. Në rrethanat normale është rasti i radhë për një relaksim të freskët, që i mbetet familjes në dispozicion. Por kjo është tej pakë. Sepse si fëmija i rritur ashtu edhe të vegjlit, meshkuj dhe femrat, qartas e shprehin mungesën e afërsisë dhe rolit të babës. Mungesa e tij ndikon shumë keq për një zhvillim normal dhe të plotë të një individi.

Dom Nikë Ukëgjini

ASIMILIMI I SHQIPTAREVE, DOMETHËNIA E VIZITES SË PAPËS NË MAQEDONI

*Dyzimet mes Lindjes e Perëndimit dhe diskutimi si u rrudhen bashkëkombësit në shtetin fqinj
- Papa Françesko më 7 maj, 2019, vizitë në Maqedoninë Veriore*

Pas vizitave, kohët e fundit, të Papa Françesko në Emiratet e Bashkuara Arabe, më 4 mars 2019, dhe Mbretërinë e Marokut, më 30 - 31 mars, tani vëmendja e Selisë së Shenjte është përqendruar në Ballkan, pikërisht në vizitën e Papës në Bullgari, më 5-6 maj dhe më 7 maj në Maqedoninë Veriore.

fetare e kulturore. Më përsosjen e organizimit kishtar, në qytet kryesore më të mëdha e më të vjetra u krijuan peshkopatat që e shtrinin juridiksionin e tyre në gjitha krahinat e Ilirisë.

Dardania ilire, ishte njëra ndër krahinat më të mëdha e më të zhvilluara në fushën e prodhimeve të ndryshme si dhe pasurive nëntokësore. Ajo si e tillë



Papa Françesko ndërmori këtë turne ballkanik, si falënderim Zotit që hap rrugët e paqes dhe miqësisë, për të cilat sot kanë shumë nevojë shtetet ballkanike, por njëherazi për të na rikthye në vëmendje, se Thrakia dhe Dardania, ishin pellgu nga gjeneroi dhe gjallëroi krishterimi si qytetërim, në të gjithë Evropën e sotme.

Eterit kishtar në shekullin II na dëshmojnë se Krishterimi hodhi rrënjët në trevat e Ilirisë që në kohën e Krishtit nga vet Shën Pali duke kaluar nga Jerusalemi në Epirin e Ri (Durrës) në rrugën “Via Egnatia”, për në Romë. Shën Andrea predikoi në Epirin e Vjetër, Shën Luka në Dalmaci dhe Shën Matia në Dardani, për të cilën jemi duke bërë fjalë. Si kudo, edhe këto vatra të krishterimit u bënë qendrat qytetare ku i ngritën bashkësitë e para

kishte qytete të zhvilluara dhe të njohura, si: Sardikën, Naissus (Nishin), vendlindja Konstantinit të Madh (306-337), i cili legalizoi në vitin 313 krishtërimin në Perandorin Romake; Remesianën, ku veproi ipeshkvi, Shën Niketa (340-414), i cili kompozoi himnin e krishterimit botëror, “Te Deum Laudamus” (Ty Hyj të Lavdërojmë); Ulpianën nga dolën martiret e parë të Krishterimit, Flori dhe Lauri në kohën e mretit Hardian (117-138) dhe Shkupin, si kryeqytet dhe vendlindja e Justinianit të Parë (527-565), i cili njihet si reformatori më i rëndësishëm i Perandorisë Bizantine. Por krishterimi i Dardanisë ilire, si vend i lakmueshëm zhvillimor, gjatë viteve pati shkatërrime të mëdha nga hordhitë pushtuese: sllave, bullgare, bizantine. Ajo pësoi dëmtime dhe

nga grindjet juridike e doktrinare që zhvilloheshin në mes Romës e Konstantinopolit, filluar që nga koha e skizmës Akacije (484), lëvizjeve ikonoklaste (730) e deri të ndarja përfundimtare e dy kishave në vitin 1054, kur dioqezat e Dardanisë dyzoheshin në mes Lindjes dhe Perëndimit. Sidoqoftë pjesa më e madhe e dioqezave kishtarë të Dardanisë i mbeten besnik papatit deri në shekullin XIV.

Kisha katolike në Dardani, edhe përkundrejt vështirësive, presioneve, luftërave të pandashme, që zhvilloheshin për nënshtrimin e saj, nga bullgarët, bizantinët dhe nga fillimi i shekulli XII, me serbët, megjithëse e goditur rëndë, do të vazhdonte ta ruante vazhdimësinë e mëparshme të ndritur, duke qëndruar e lidhur shpirtërisht dhe juridikisht më Romen.

Duke filluar nga viti 1219, në Dardani, përballë trysnive të sllavo-ortodoksizmit për përvetësimin e kishave romake, sipas dokumenteve, dëshmohej prania e kishave katolike arbërore, në Shkup, Tetovë, Prizren, Graçanicë, Trepçë, Novobërdë etj., në të cilat kultivohej gjuha shqipe. Për prezencën e elementit arbëror në këtë treve, flet shumë qartë shkrimtari bizantin i Atalietes, kah fundi i shek. XI, duke u shprehur së Albanët janë latin, që do të thotë të ritit romak.

Situata në Dardani ndryshoi mënyrë drastike me shpalljen e ligjit të Car Dushanit “Kodi i Dushanit” në vitin 1349 në Shkup, me anë të cili u nxit një armiqësi e madhe ndaj kishës katolike dhe arbërorëve në përgjithësi. Më këtë rast pothuajse të gjitha kishat dhe manastiret katolike u përvetësuan, duke i shndërruar në Kisha dhe manastire ortodokse sllave dhe popullata arbërore asimilohej ditë për ditë.

Ardhja e pushtuesve turq në Ballkan ndryshoi gjeopolitikën edhe në trevat arbërore si dhe hapësirën e Dardanisë. Ajo çfarë nuk u arrit të shkatërrohej nga mbreti Dushani, u zbatua nga turqit aziatik, kur pas një qendrese prej më tepër së njëqind vjetësh, tokat shqiptare në fillimet e shek. XVI u përfshinë tërësisht në sundimin e këtij pushteti shkatërrues për pesë shekuj me radhë.

Turqit rrënuarn shumë kisha katolike deri në themel, të tjerat i tjetërsuan, dhe ipeshkvijnjtë latin përndiqeshin duke ua ndaluar të udhëhiqnin grigjën nga selitë e veta siç ishin: Shkupi, Ohri e Prizreni, por ata duhej të vepronin nga fshatrat e vendet malore për rreth e qark dioqezave. Këto masa dhe të tjerat ndëshkuese, sollën dhe islamizimin e arbërorëve të Dardanisë së dikurshme, duke arritur në shek. XVIII të islamizoheshin në masën deri në 90% të tyre. Politika perandorake në qarqet

ndërkombëtare masën e islamizuar e ka paraqitur si turke, pjesën katolike si latine, ndërsa atë ortodokse si greke.

Si pasojë e trysnive turke, me vdekjen e Andre Bogdanit, në vitin 1656, u shua përfundimisht kryedioqeza e katolike e Ohrit, ku që më herët pjesa më e madhe e besimtarëve kishte kaluar në Kishën Ortodokse. Dhe si fanar e ruajtjes së traditës të Kishës romake dhe identitetit kombëtar, tani e vetme kishte mbetur kryedioqeza e Shkupit, e cila administronte katoliket në “Serbinë e vjetër” të emërtuar kështu nga Car Dushani, dhe një pjesë të Bullgarisë. Po kështu, nga përndjekjet e turke, ndihmuar nga kisha serbe, ipeshkvijtë e kësaj kryedioqeze nuk mund të qëndronin për të ushtruar detyrat e tyre baritore nga selia e Shkupit, por e bënë nga famullitë e ndryshme si: Hasi, Janjeva, Gjakova, Prokupje e gjetiu.

Sipas relacionit të Kuvendit të Arbrit, i mbajtur në Merqi të Lezhës në vitin 1703, e ku Papa Albani - Klementi XI, i pat bashkuar përfaqësuesit e të gjitha trevave arbërore, Kryedioqeza e Shkupi kishte rënë në minimumin e saj, duke pasur 6 famulli, më 770 shtëpi dhe 5. 296 besimtarë katolikë. Më këtë rast ajo administronte edhe 2. 061 katolikë në Bullgari.

Në përballjet shumëshekullore me pushtuesit turq e serb, në ruajtjen e historisë dhe traditës dardane, qëndruan stoikisht prelatët e shquar të kishës katolike, si: Imzot Pjetër Budi, poet e përkthyes i “Doktrinës së Krishtenë”, në vitin 1618; Imzot Pjetër Bogdani, autor e Çetës së Profetëve, 1698; Imzot Gjon Nikollë Kazazi, letrar, zbulues i “Mesharit” të Buzikut, 1740, në Romë dhe shkrues në shqip i librit, “Doktrina e Krishtene” 1743; Imzot Andre Llogoreci, 1887-1901, përkthyes dhe organizator i rihapjes së disa shkollave shqip, në Shkup, Gjakovë e Prizren; Imzot Lazër Mjeda, 1909, nxitës i përhapjes i kulturës shqiptare në këto treva dhe luftëtar i paepur në ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë etnike, gjatë luftës Ballkanike e tjerë.

Në kohën kur po shkatërrohej Perandoria osmane, sidoqoftë evidentohet së kishte mbijetuar një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve në Maqedoninë e sotme. Sipas statistikës turke të vitit 1908, në Maqedoninë e Veriut jetonin 341. 639 shqiptarë. Ndërsa pas krijimit të Mbretërinë Serbe - Kroate - Sllovene, më 1 dhjetor 1918, llogariten së në Maqedoni, e cila quhej Banovina e Vardarit, në vitin 1921, jetonin 28.4 % të shqiptarëve. Ndërsa shqiptarë të besimit katolik në Maqedoni e Kosovë, për të cilët përkujdesej kryedioqeza e Shkupit, ishin

30.336 besimtarë shqiptarë.

Mbas shkatërrimin e ish - Jugosllavisë dhe përfundimit të luftës në Kosovë, në vitin 1999, situata kishtare mori një kaheje tjetër. Për shkak të rrethanave politike, dioqeza e Shkupit me 25 maj të vitit 2000, qe shkëputur nga dioqeza Prizrenit, më të cilën ka bashkëvepruar nga viti 1969, duke vepruar tani secila për llogari të vet. Shkupi, vendlindja e nobelistës shqiptare, Nënë Terezës, tani kishte mbetur me 6.320 besimtarë, nga të cilët pjesa më e madhe janë katolikë të ritit bizantin, që mbahen si maqedonas apo bullgar dhe 2.000 prej

Ballkanit, të gjitha analizat serioze janë të një mendimi se, edhe përkundrejt gjendjes me gotën gjysmë të zbrazur në aspektin shpirtëror, moral, mendor, ekonomik, në të cilën gjendemi, ky gjysmë shekull konsiderohet se është në favor të shqiptarëve. Në këtë vështrim, vizita në Maqedoninë e Veriut e Papa Françeskut, i cili personifikon shtetin sipas modelit “De Civitatis Dei” (shteti i Hyjit), të Shën Agustinit, është dhe një ditë e jona, kur të gjithë pa dallime, më 7 maj të këtij viti, të organizuar nga të gjitha trevat, duhet të nisemi drejt Shkupit, në shenjë vlerësimi e nderimi



tyre janë shqiptarë të përqendruar në Shkup, të cilët për çdo ditë janë duke u asimiluar. Megjithatë disa statistika flasin së në vitin 2002, besimtar të të dyja rriteve, janë 13.711.

Sot Maqedonia e Veriut, sipas statistikave të Eurostatit të vitit 2016, ka 25.2% ose 600.000 shqiptarë. Ndërsa të dhënat nga terreni flasin për një shifër deri në 30-35 %. Sidoqoftë në krahasim më vuajtjet e pa masë, si: shpërngulja në Turqi më 1938 dhe 1953, diskriminimi në forma të ndryshme që i ka shoqëruar shqiptarët në të kaluarën nën regjimin sllavo-ortodoks, sot mbetet prezent një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve në këtë republikë.

Sot duke pasur parasysh ndryshimet nacionale, politike e ekonomike etj., në këtë pjesë të

për çfarë ka bërë Selia e Shenjte, në të kaluarën për ne shqiptarët.

Po kështu, vizita e Papës në Maqedoninë Veriore, ka për qëllim të hapë rrugët e paqes dhe miqësisë në këtë vend tejskajshëm të përgjakur gjatë tërë historisë, në dyzimet në mes Lindjes e Perëndimit. Për ne shqiptaret është dhe momenti, kur Papati na ofron si në Kuvendin e Arbrit, qoftë edhe në aspektin shpirtëror, ngjitjen e fijes së shkëputur, e cila ndodhi në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, kur trojet tona qenë shpërndarë shteteve fqinjë padrejtësisht.

*Marrë nga: Gazeta Shqiptare,
14 prill 2019.*

Don Lush Gjergji

VIZITË TROJEVE DARDANE

*Me rasti e vizitës së Sekretarit të Shtetit të Vatikanit,
Eminencës së Tij, Kardinal Pietro Parolin, në Dioqezën Prizren-Prishtinë
Prishtinë – Prizren, 8-10 qershor 2019*

Krishterimi ndër ilirët

Krishtërimi ndër ilirët i ka rrënjët e lashta apostolike, që nga zanafilla, me Shën Palin dhe nxënësit e tij, të cilët e sollën Ungjillin ndër të parët tanë. Për këtë kemi dëshmi biblike, historike dhe arkeologjike, që bindshëm tregojnë se të parët tanë,

kishte lulëzuar dhe përparuar shpejt pothuaj në të gjitha trojet e “Illiricum sacrum”, dhe “Dardania sacra”, ku jetonin paraardhësit tanë. Populli ynë shqiptar, si pasardhës të Ilirëve, është aut okton nga lashtësia që tejkalon çdo kujtim apo njohuri historike. Qysh Shën Pali e përmend Ilirikun,



Ilirët, ishin populli i parë në Mesdhe dhe në Europë, që ishte ungjillëzuar dhe kishte pranuar Jezu Krishtin, shpëtimtarin e mbarë njerëzimit. Për Kosovën tonë, Dardaninë e dikurshme, dëshmojnë martirët Shën Flori dhe Lauri, ndërtuesit e tempullit pagan në Ulpianë, sipas kërkesës së perandorit romak Hadrianit (117-138). Pastaj në Konkilin e Nicesë (325), që e kishte ftuar dhe organizuar perandori romak Konstantini i Madh, ilir, dardan, i cili e kishte dhënë edhe Ediktin e Milanos (313), lirinë fetare për të krishterë, në të cilin kishte marrë pjesë edhe ipeshkvi Dacus Dardaniae – Daku Dardanas. Pas dhënies së lirisë fetare, krishterimi

Epirin, Dalmacinë dhe Maqedoninë. Ai shkruan kështu: “Kështu, qysh prej Jerusalemit e përfaqë në Iliri e kam përhapur Ungjillin e Krishtit” (Rom 15, 19). Në një vend tjetër ai i shkruante Titit kështu: “Kur ta dërgoj te ti Artemin ose Tihikun, hiq e eja te unë në Nikopol, sepse atje vendosa ta kaloj dimrin” (Tit 3, 12; khs. Tit 3, 7; 2 Tim 4, 10). Nikopoli ishte aso kohe qyteti më i njohur i Epirit, në afërsi të Ilirikut. Pjesët ku kryesisht jetonin Ilirët ishin: Prevalitana, Epiri, Dardania dhe Maqedonia,

Gjatë sundimit të perandorit Hadrianit (117-138), pati disa përndjekje kundër të krishterëve në Ulpianë, kryeqyteti i Dardanisë, Kosovës së sotme,

ku spikasin dy martirë të shquar: Shën Flori dhe Shën Lauri, që paraqesin zanafillën, “djepin” dhe rrënjët e krishtera. Rrënjët e mirëfillta të bamirësisë dhe të bujarisë, të mikpritjes ilire, arbërore dhe shqiptare, janë të pranishëm qysh me Shën Florin dhe Laurit, të cilët i kishin pagëzuar në pjesë të mirë të bashkëndërtuesve të “Tempullit romak”, si dhe bashkëqytetarëve të Ulpianës, pikërisht duke u mbështetur në dashurinë e krishterë, që shprehej, dhurohej dhe dëshmohej nëpërmjet bamirësisë dhe vëllazërisë së krishterë. Pas shekujve të përndjekjeve ndaj të krishterëve, së fundi erdhi Edikti i Milanos (313) i Konstantinit të Madh, me prejardhje ilire dhe dardane, që ua mundësonte lirinë fetare edhe të krishterëve, dhe së fundi edhe ai u bë i krishterë. Kjo ngjarje bëri që krishterimi të lulëzonte në Mesdhe si dhe në pjesë të ndryshme të Europës dhe të botës, sidomos në trojet ilire, ku me shekuj ishte ujitur me gjak fara e Jezu Krishtit dhe besnikëria ndaj Kishës katolike. Qysh në Konkilin e Nicesë (325), ku janë definuar të vërtetat themelore të fesë së krishterë, Besojma, ishin të pranishëm dy ipeshkvij të pjesëve tona: Daccus Dardaniae, dhe ipeshkvi i Stobit, Budi Stobiensi, që dëshmon bindshëm që krishterimi në këto hapësira ishte tashmë i organizuar mirë dhe në lulëzim.

Kisha vuan dhe qëndron

Periudha e sundimit turko-otoman (1468-1912), ishte e vështirë dhe tejet e errët. Pas qëndresës heroike 25 vjeçare të heroit kombëtar Gjergji Kastrioti – Skënderbeut (1405-1468), tokat ilire-arbërore kishin rënë nën sundimin turko-otoman. Një pjesë e shqiptarëve kishte mërguar në Venedik, të tjerë, për t’iu shmangur dhunës dhe hakmarrës, në Italinë Jugore, Arbëreshët e sotshëm, në Kalabri dhe në Sicili, si dhe gjetiu. Sundimi turko-otoman ka shkaktuar islamizimin e pjesës së madhe të popullit tonë. Nga krishterimi në popullin shqiptar jo rastësisht gjatë shekujve të sundimit turko – ottoman, kemi figura të ndritura të fesë dhe të kombit, siç është Imzot Pal Engjëlli, Don Marin Barleti, Imzot Pjetër Budi, Imzot Pjetër Bogdani, Papa Klementi XI – Albani, deri te Atë Gjergj Fishta, Atë Shtjefën Gjeçovi e shumë e shumë tjerë. Pa veprimtarinë dhe kontributin e tyre, nuk do të ruhej në Popullin tonë feja e krishterë, por as vetëdija kombëtare ilire, arbërore dhe shqiptare, gjuha, tradita dhe kultura jonë e lashtë dhe shumë e lavdishme.

Sfidat dhe sprovat në shekullin XX

Në vazhdimësinë e kësaj tradite, lashtësie, autoktonie, martirizimi, nga rrënjët tona të vjetra, por gjithnjë edhe të gjalla, nëntokësore, kanë lindur dhe janë rritur dy protagonistë fetar dhe shpirtëror të shekullit XX, Atenagora I (1886-1972), dhe Shën Nëna Tereze (1910-1997), që i kanë dhënë një “frymëmarrje të re” Kishës dhe botës. I Pari, me dialog ekumenik dhe ndërftar, e Dyta, me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë për të gjithë. Pas stuhive të ndryshme që kishin goditur fenë e krishterë gati gjatë shumë shekujve, dukej se shekulli XX do të jetë sadopak më i mirë dhe më i përshtatshëm për ne dhe për Kishën tonë ndër shqiptarë.

Mirëpo vetëm pjesërisht ishte kështu. Me rrënimin e perandorisë turko-otomane dhe formimin e Shqipërisë, tokat dhe populli ynë ishte në një lloj “tregtie apo pazari” të pandershëm nga orekset e fuqive të mëdha dhe fqinjëve të pangopur. Formimi i shtetit shqiptar ishte një sukses i vogël për ne, pasi një pjesë e madhe e trojeve dhe popullit tonë mbetën jashtë, të copëtuar dhe rishtas të robëruar nga sundimtarët e ri.

Nëse analizohet dhe shqyrtohet historia jonë mijëvjeçare, atëherë mund të konstatojmë vërtet dy mrekulli: a) mbijetesën tonë kombëtare, si ilirë, arbërorë dhe shqiptarë, dhe b) mrekullinë e mrekullive, mbijetesën e fesë së krishterë në Popullin tonë. Këto dy dhurata tejet të mëdha dhe shumë të rëndësishme, për shumëçka edhe vendimtare, janë pa dyshim fryt i Provanisë Hyjnore dhe i historisë tonë shumë të vështirë, të përgjakshme dhe tejet të lavdishme. Në aspektin kishtar, besimtarët tanë në shekullin e XX patën ende shumë batica dhe zbatica. Ja vetëm disa prej tyre: Më 24 gusht 1914 është lidhur konkordati mes Selisë së Shenjtë – Vatikanit dhe Serbisë, me të cilin Ipeshkvisë sonë me Seli në Shkup i merret titulli i argjipeshkvisë, për ta kaluar të njëjtin Ipeshkvisë së Beogradit. Dhe nuk përfundon me kaq. Shteti i Jugosllavisë së vjetër, mbretërore, për shumëçka është i ngjashëm me atë turko-otoman, për ne s’ nuk ka kurrfarë drejtësie dhe lirie. Mungesa e shkollave shqipe, atë pak që kishin mbijetuar nga koha e Turqisë, mbyllën dhe përndjeken.

Me këtë shkaktohet mungesa e klerit tonë vendor, që zëvendësohej me kler të huaj.

Argjipeshkvi Imzot Lazër Mjeda detyrohet të largohet nga selia ipeshkvore, më 19 tetor transferohet zyrtarisht në Shkodër, kuptohet nën ndikimin dhe trysninë e politikës sllave. Ai, vërtet edhe më parë e kishte lëshuar Shkupin dhe selinë, duke mbetur kleri dhe populli pa Bari, dhe gjatë kohës së selisë së zbrazët “sede vacante”, administrator ishte Don Tomë Gllasnoviqi.

Politika kishte ndikuar, deri diku edhe kishte kushtëzuar, emërimet e tri gjeneratave të ipeshkvijve jo shqiptar: Imzot Ivan Gnidovev (1924 – 1939); Imzot Smiljan Franjo Čekada (1940 – 1967) dhe Imzot Joakim Herbut (1969 – 1992), ndërsa ipeshkëvn ndihmës “sedi datus” për shqiptarë ishte Imzot Nikë Prela (1969 – 1996).

Selia e Shenjtë, në krye me Papën Shën Pali VI, mundohet në një mënyrë t'i përmirësoi këto pamundësi dhe pengesa, me një kujdes të veçantë për grigjën tonë të vogël dhe të mbijetuar nga stuhitë shekullore.

Kështu, më 20 tetor 1969, pas emërimit të dy ipeshkvijve të ri, ripërtërihet selia e dikurshme ipeshkvore e Prizrenit, duke e lidhur menjëherë atë me Shkupin, pra, formohet Ipeshkvia Shkup-Prizren.

Rilindja shpirtërore dhe kishtare

Me ardhjen e ipeshkvit shqiptar Imzot Nikë Prelës, shumëçka ndryshon dhe përmirësohet. Rritet gjithnjë numri i thirrjeve meshtarake dhe rregulltare, ndërtohet kisha të reja, si dhe meremetohen kishat dhe shtëpitë e vjetra famullitare; fillon katekizmi i rregullte për fëmijë, pjesërisht edhe për rini. Në kuadër të kësaj gjallërie të gjithanshme, fillon shtypi katolik shqiptar me revistën fetare dhe kulturore “DRITA”, që pastaj rritet dhe zhvillohet edhe në shtëpi botuese, e vetmja si e tillë, katolike, në kohën e atëhershme.

Me pak fjalë, Kisha jonë del prej “sakristisë” dhe oborrit të kishës, është gjithnjë e më tepër e pranishme në skenën e jetës së popullit, me pjesëmarrje në ngjarjet shoqërore dhe kulturore shqiptare në Kosovë dhe më gjerë, siç janë Pajtimet e Gjaqeve, Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës “Nëna Tereze”, Caritasi i Kosovës, përkrahja e sistemit paralel shkollor dhe shëndetësor, mbrojtja e popullit tonë padrejtësisht të shkelur dhe të përndjekur ndër ne, në ish-Jugosllavi dhe në botë. Zëri ynë tashmë bëhet i

fuqishëm, prania jonë shumë e gjallë dhe e fortë, qëndrimet tona profetike dhe providenciale, jo vetëm për shqiptarët katolikë, por për mbarë Kombin tonë. Nga kjo përvojë e vështirë dhe sfiduesi për Popullin dhe Kosovën tonë, erdhi në pah Dr. Ibrahim Rugova, figurë studiuese e Imzot Pjetër Bogdanit, karizmatike dhe vizionare, më vonë krijues dhe përkrahës i strategjisë paqësore jodhunore, Presidenti ynë historik, të cilin e ka përkrahur vazhdimisht Kisha jonë. Dhuna e paparë serbe ndaj popullatës së pafajshme dhe të pambrojtur shqiptare, detyroi që disi ta mbrojmë jetën, shtëpitë dhe vatrat tona, sidomos fëmijët, pleqtë dhe botën femërore edhe me armë nëpërmjet UÇK-së, si dëshmi botore që çdo gjë ka ndonjë kufi. Në periudhën para, gjatë dhe pas Luftës, në krye të Ipeshkvisë ishte Bariu ynë Imzot Mark Sopi (1996 – 2006), i cili guximshëm dhe urtisht ka vazhduar në vijën e Imzot Nikë Prelës dhe prelatëve tanë gjatë shekujve, për Zotin dhe për Popullin, me orvatje dhe veprimtari në dobi dhe të mirë të besimtarëve tanë, por edhe të mbarë Kosovës, me paraqitje të dinjitetshme dhe argumentuese në forume euro-amerikane, me ndihma humanitare, me përkrahje të plotë të paqes dhe pajtimit ndër ne.



Selia e Shenjtë, pas ndarjes “ad interim” nga Shkupit (1992), mori një vendim dhe gjeti një lloj zgjidhjeje të përkohshme (2000), fill pas Luftës dhe ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, duke e shpall ipeshkvin tonë Shkup – Prizren, Administraturë Apostolike të Prizrenit (për pjesën e Kosovës), dhe duke e ndarë përfundimisht nga Ipeshkvia e Shkupit, paralelisht me administrimin ndërkombëtar të Kosovës nëpërmjet UNMIK-ut. Pas vdekjes së papritur të Imzot Mark Sopit (11 janar 2006), Administraturën Apostolike të Prizrenit e ka udhëhequr Imzot Zef Gashi, si administrator apostolik, deri te emërimi i Imzot Dodë Gjergjit (2006 –), ipeshkvi ynë aktual. Imzot Dodë Gjergji ndërmori shumë iniciativa, ndër të cilat dallohen: rifillimi i revistës “DRITA” dhe botimet e saja, e cila nuk dilte që nga vitet e '90, për shkaqe të njohura; ristrukturimi i famulltarëve nëpër famulli dhe Misione Katolike Shqiptare në Europë; ndërtimi i Rezidencës Ipeshkvore, Katedrales dhe Shenjtërores Shën Nënë Tereze në Prishtinë; përpilimi dhe botimi i planit baritor për Administraturën Apostolike të Prizrenit, me titull “Shërbejmë me përvujtëri e kumtojmë me hare” 2015-2020; themelimi i Shkollës Katekistike Dioqezane në Prishtinë (2014), festimi i 100 vjetorit të lindjes së Nënës Tereze (2010); shugurimi i Katedrales dhe Shenjtërores “Nënë Tereze” në Prishtinë në vitin 2017. Shugurimi ishte vepër madhore e Zotit, kujdes atëror i Papës Françesku ndaj Administraturës Apostolike të Prizrenit, Kosovës, me domethënie historike dhe aktuale. Prijës në Meshë të madhërishtme ishte kardinali ynë Ernest Simoni, i deleguari i posaçëm dhe personal i Papës Françesku, Imzot Dodë Gjergjin, shumë ipeshkvijve, meshtarëve dhe besimtarëve nga vendet e ndryshme të botës.

Papa Françesku kishte shkruar dhe dekretuar kështu: *“Për ta kryer këtë rit në mënyrë sa më të lavdishme, vendosëm të dërgojmë përfaqësuesin tonë.*

Ty, i nderuari Vëllai ynë, Bir i këtij Populli, po të emërojmë dhe po të shpallim të Dërguarin tonë të jashtëzakonshëm.

Prandaj, do të kryesoni liturgjinë e shenjtë, ndërsa Vëllai i Nderuar Dodë Gjergji, Administrator Apostolik i Prizrenit, do ta shugurojë, më 5 shtator, me rit solemn këtë Tempull të shenjtë kushtuar Shën Nënë Terezës së Kalkutës.

Theksoj se kjo Shenjtërore e bukur duhet të ndihmojë për përforcimin e fesë së vërtetë të besimtarëve. Me kënaqësi e shtrijmë Bekimin Apostolik, së pari mbi Ty, e përmes Teje, në emrin tonë, mbi gjithë të pranishmit, që ky bekim, me ndërmjetësimin e së Lumes Virgjër Mari e të Shën Terezës, të jetë gurrë hiresh të larta për përtëritjen e shpirtrave, ndërsa ne, me pushtetin e Shën Pjetrit, i bashkuar në lutje, urojmë që ky bekim të jetë sa më i frytshëm”.

Prej Selisë së Vatikanit, 1 gusht 2017, viti i pestë i Papnisë sonë. Françesku

Nunci Apostolik për Kosovën , Mons. Juliusz Janusz, gjatë meshës në Prishtinë

Shenjtërorja Shën Nënë Tereze në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, ka dy qëllime dhe synime thelbore: “kthimin” apo mishërimin e saj në mendjet dhe zemrat tona, si dhe ndërmjetësimin e saj për Kishën dhe Popullin tonë. Kështu, në këtë “shkollë” të dashurisë, ne do ta mësojmë dhe zbatojmë kulturën e jetës dhe qytetërimin e dashurisë, virtyte këto që Nënë Tereze i mori ndër ne dhe i dëshmoi dhe i barti në mbarë botën.

Një vit më vonë, më 5 shtator 2018, nga Zoti, nëpërmjet Papës Françesku, na erdhi edhe një lajm dhe dhuratë e madhe, lartësimi i Administraturës Apostolike të Prizrenit, në Ipeshkvi të re Prizren – Prishtinë, në dyvjetorin e shenjtërimit të Nënës Tereze dhe një vjetorin e shugurimit të katedrales kushtuar asaj.

Nunci Apostolik për Kosovën, Mons. Juliusz Janusz, gjatë meshës kremtoare me Imzot Dodë Gjergjin, Imzot Rrok Gjonlleshaj, në prani te shume besimtareve e qytetareve te ardhur edhe nga vende tjera te Kosovës e me gjerë, përfaqësues të bashkësive të ndryshme fetare, deputetë te Kuvendit te Kosovës, miq dhe personalitete të kulturës e të artit, ndër të tjera tha:

“Kam ndjenje te veçantë që jemi përsëri bashkë në Prishtinë, ne këtë Shenjtërore të mrekullueshme kushtuar Nënës tonë, Shën Nënë Terezës, që e keni ndërtuar me bujaritë tuaja, zemrat tuaja. Mbase nuk mund të ishte ndryshe pasi Shën Nënë Tereza ka qenë themeluese e Kongregatës “Misionaret e Dashurisë” në Kalkute në vitin 1950. Pesë shtatori mbetet jo vetëm në historinë e Kosovës, por të mbarë botës, është Dita e Shenjtërimit të Nënë

Terezës. Nëna Tereze ka dëshmuar se Dashuria është e vështirë, sikurse martirizimi, sepse ndërtimi i dashurisë pa dallime race, feje e ngjyre, janë vepra të saj të krahasueshme me martirizimin” përfundoi Nunci. Me pas shkëlqesia e tij, Imzot Dodë Gjergji, pasi falënderoi Nuncin Apostolik për pjesëmarrjen dhe predikimin e tij, vazhdoi kështu: “Jemi shumë të gëzuar për këtë dhuratë të Zotit e të Papës, për lajmin se tash jemi Dioqeza Prizren – Prishtinë. Populli i Kosovës është falënderues dhe mirënjohës Shën Palit, që e ka përhap lajmin e gëzueshëm për krishterimin deri në Ilirik, pastaj vuajtjeve shekullore të popullit tonë, imzot Pjetër Bogdanit, Nënës Terezë, e kështu me radhë, që mbajtëm gjallë fenë e të parëve tanë, brez pas brezi, deri në ditët tona, që Kisha Katolike po lulëzon ditë për ditë në vendin tonë, në Kosovën e sotme, Dardaninë e dikurshme”, përfundoi Imzot Dodë Gjergji.

Bula e ngritjes së Administraturës Apostolike në Dioqezë Prizren – Prishtinë

Administratura Apostolike e Prizrenit ngritët në shkallën dhe dinjitetin e dioqezës, që do të quhet Prizren – Prishtinë, dhe kjo njësi e re kishtare ka ipeshkvin e saj.

Françesku Ipeshkëv, Shërbëtori i shërbëtorëve të Zotit, në kujtim të përjetshëm.

Na është besuar Neve, nga vetë Zotëria i mbarë Kishës së përgjithshme, shërbimi i tërë i kujdesit për zhvillimin e shpejtë, që ato të mira shëlbuese dhe mësimë, të mbërrijnë pa vonesë dhe me sukses në çdo vend. Prandaj Ne kemi vendosur të përshpejtojmë dhe rregullojmë këtë çështje sa më parë dhe sa më lehtë. Për këtë arsye me të nderuarin Vëlla Dominik (Dodë) Gjergji, ish-ipeshkëv në Sapë, Administrator Apostolik në Prizren, i cili ka kërkuar që rrethi kishtar i tij të ngritët në shkallën dhe dinjitetin e ipeshkvisë, i përkrahur nga Vëllai i nderuar Juliusz Janusz, argjipeshkëv titullar i Caprulanos dhe Delegat Apostolik i vendit, që quhet Kosova, nga këshilli i Sekretarisë së Shtetit dhe Kongregatës për Ipeshkvij, me Pushtetin tonë Apostolik kemi vendosur. Administratura Apostolike e Prizrenit të ngritët në dinjitetin e dioqezës, që tash e tutje duhet të quhet Prizren – Prishtina, dhe të jetë menjëherë nën Selinë Shenjte, si e tillë duke ruajtur kufijtë që

janë caktuar dioqezave të Konferencave Ipeshkvore ndërkombëtare Shën Çirili dhe Metodi, anëtare e së cilës është. Prandaj në qytetin e Prizrenit, gjendet kisha me emërtim të Shën Marisë Virgjër Ndhmës së Krishterëve, ngrihet në dinjitetin e Kishës Katedrale, njëkohësisht kisha e Prishtinës, e shuguruar në Vitin e Zotit më parë, në nder të Shën Terezës së Kalkutës, kishë konkatedrale, që të dyjave të dalluara, ju jepen privilegje dhe nderi njëjtë. Gjërat tjera rregullohen me norma kanonike. Për më tepër Vëllain e Nderuar Dodë Gjergjin, me këtë komunikim kishtar e shpallim Ipeshkëv dhe Bari dhe lirohet nga kufizimet e mëparshme. Të gjitha këto ia besojmë që të përcjellën nëpërmjet delegatit Apostolik në Kosovë, natyrisht me autoritet të ndonjë njeriu tjetër me dinjitet kishtar dhe të caktuar për delegim. Për të ardhur deri te zgjedhja përfundimtare, me dokumente të plotësuar, natyrisht le t'i dërgohen Kongregatës për Ipeshkvij. Kjo ka fuqi, pavarësisht rezistimeve më të vogla të ndokujt.

Romë, te Shën Pjetri, dita e pestë e muajit shtator 2018, të Pontifikatit tonë të gjashtë.

Papa Françesku

Pietro Card. Parolin, Sekretari i Shtetit

Marco Card. Quellet, Prefekt i Kongregatës për Ipeshkvij

Shpallja zyrtare e Bullës dhe intronizimi i Imzot Dodë Gjergjit për ipeshkëv të Dioqezës së re Prizren-Prishtinë u bë në Festën e Zojës Ndhmëtare, më 24. 05. 2019, në Katedralen Zoja Ndhmëtare në Prizren, nga Nunci Apostolik në Slloveni dhe Delegati Apostolik për Kosovë, Imzot Jean-Marie Speich, në prani të klerit dioqezan, rregulltarëve e rregulltarëve dhe popullit të Zotit./drita.info



Mërgim KORÇA

HISTORIA DHE MUSTAFA MERLIKA KRUJA*(Pjesa e tretë)****(Komente rreth Letërkëmbimit Mustafa Kruja – Patër Paulin Margjokaj)***

Letra me nr.53, në përgjigje të letrës Padres ku ai i shtron M.Krujës pyetje karakteri themelor historije kombëtare, nuk mund të ishte e shkurtër, (Fq.191 – 214). Në përfundim vetë autori i drejtohet Padres duke i theksuar : “... me këtë kapitull Të kam dhënë çelsin e historis politike shqiptare ashtu siç e shoh e e gjykoj un vetë. Mund të jem i gabuem, mund të kemë harrue a mbajtur mënd keq ndonji pikë ndër hollsinë që s'e prek e s'e cënon themelin; por të jesh i sigurtë se me qëllim s'kam ndryshue asnjë gërmë...”.

Vetë ky pohim i M.Krujës në përfundimin e shtjellimit të pyetjeve që kërkonin përgjigje, menjëherë e intrigon lexuesin kureshtar të mësojë se si i trajton M.Kruja problemet. Unë as nuk do t'ia prish bukurinë leximit të materialit origjinal e as do t'ia shuaj kureshtjen atij që dëshiron t'a lexojë materialin e plotë, duke cituar ndonjë kalim. Përkundrazi, do t'ia mpreh akoma më shumë dëshirën e leximit të plotë duke cituar dy nga pohimet madhore të M.Krujës të cilët janë leksione si edhe themele etiko – morale mbi të cilat duhet të jetë mbështetur mirë historiani tek e fillon ai trajtimin e problemeve. M.Kruja pohon : “... gjyqtarët n'Angli përpiqen me i kufizue sa më fort që munden miqsi të tyne. Edhe historjani mund të krahasohet shumë mirë me gjyqtarët, se edhe ai është një gjyqtar, sidomos ky krahasim vlenë aq më tepër po që se marrim me shkruar historinë kohës sonë.”

Në vazhdim, gjithmonë përgjatë kësaj hullije, M.Kruja këmbëngul në pohimin madhor : “ Miqsija e mirnjohja janë sende të shënjtë, por ka përmbi ta një gjatjetër edhe më të naltë : e vërteta.”

Që të dy këta pohime madhorë të M.Krujës, posaçërisht në kushtet e sotme të zhvillimeve post - komuniste në Shqipëri, do të ishin objekt trajtimi më vete si në shtrirje e gjithashtu edhe në thellësi të një analize konkrete shumë interesante. Është qartë se një analizë e tillë në vazhdim, do t'a devijonte vetë objektin e temës që trajtohet, (e prandaj nuk po bëjmë përqasje as me gjyqtarë e as me historianë bashkëkohës). Prandaj, në sintoni me linjen që i kemi vënë detyrë vetes që të ndjekim, (përgjatë trajtimit të letrës me nr. 53), nuk i

shmangemi dot sjelljes para lexuesit edhe të një pozicionimi të M.Krujës, i cili është shëmbëlltyrë e një qëndrimi karakterial konsekuent. Tregon M.Kruja se si Esat Pashë Toptani i drejtohet Xhemil Bej Vlorës duke i thënë për Mustafën : ... Ky është më i madhi kundërshtar i im, ky që kam pasë kujtue se s'do t'ia pritonte edhe pushkë me qitun për mue, si axha i vet ! E M.Kruja flakë për flakë i përgjigjet : “Pashë, hiq dorë prej këtyne punëve që ke nisun për dâm të Shqipnis e provomë atëherë a qes a s'qes pushkë për ty !” Ky qëndrim i M.Krujës patjetër që më shtyn t'ia drejtoj lexuesit pyetjen vërtet retorike, (që në rastin e M.Krujës aspak e tillë, sepse historiografia komuniste ç'nuk volli kundra tij përgjatë dhjetëvjeçarësh), se si e gjykon lexuesi tashti, nën dritën e re që hidhet rreth personalitetit të M.Krujës, patriotizmin si edhe karakterin e tij ?

Derisa M.Kruja ka mbajtur letërkëmbim të rregullt me Padren, siç është përmendur edhe më parë, kuptohet se ai e vlerësonte lart vetë fratin. Mirëpo përgjatë kësaj analize të vëllimit me letërkëmbimin e cituar, nisur nga fakti se protagonist i është M.Kruja i cili sjell faktet historike edhe jep në vazhdim gjykimet e tij, doemos figura e Padres, ndonëse kuptohet se ai ka qenë nxitësi i bisedave, detyrimisht ka ngelur dishka si në hije. Për t'i dhënë pak larmë analizës e doemos edhe për të hedhur së rishmi dritë mbi figurën e Padres, po i sjellim lexuesit pyetjen nr.5 që françeskani i drejton M.Krujës (nga 12 pyetjet e letrës me nr. 56) :

5) Mons.Kaçorri, me të cilin - si më ke shkruar përpara – kenë pasë punë sa heresh, a është kenë më fort italoofil apo austrofil a por është kenë shqiptar i saktë si Ti e Luigji, që mendojnë kryekrejt të mirën e atdheut pa u fiksue në një idë : jo Itali, jo Austrí, jo Francë e jo Gjermaní !

Me pyetjen që frati drejton si edhe me bindjen e tij të shprehur pa mëdyshje ose dyshime, duhet vënë në dukje së pari, se si ai me ndershmërinë si edhe atdhedashurinë që e karakterizojnë dhe pa u prirur fare nga fraternalizmi ekleziast heton, kur është fjala për besnikëri kombëtare, edhe Monsinjinorin e tij ! Nga ana tjetër, sa bukur e shpreh

ai pozicionimin e tij nga lartësít'e vitit 1952, lidhur me shqiptarofilinë e dy laikëve, Mustafa Krujës dhe Luigj Gurakuqit ! Çfarë shëmbulli për t'u marrë si model i një qëndrimi të prerë atdhetar, objektiv si edhe mospërfillës i shkarravinave pseudohistorike të kalemxhinjëve të periudhës komuniste, për të cilat ai ishte krejtësisht në dijení ! Qëndrova tek kjo pika “5” e pyetjeve të fratit françeskan, sa për të hedhur një rreze drite më të shtrirë edhe mbi Padren.

E tashti doemos duhet t'i kthehemi e t'i a përndritim lexuesit përgjigjen që jep M.Kruja : “Kaçorri ka mendue thjesht e vetëm si më i kulluati Shqiptar idealist , e ashtu edhe ka veprue.”

E donte dhe e priste këtë përgjigje frati, për Monsinjinorin e tij; sepse e donte të pamëdyshur. Nga ana tjetër aq më shumë të vyer e konsideronte ai përgjigjen, se e dhënë nga një laik feje muslimane ! Nga ana tjetër M.Kruja, tejet objektiv dhe i ndershëm, duke dijtur t'i gjykojë qëndrimet të pandara nga rrethanat, kushtet si edhe mundësitë për të arritur sa më maksimalisht objektivat nga kënvështrimi atdhetar, jep gjykimin e tij t ë p r e r ë ! Nuk qëndroj dot pa hedhur dritë edhe sa i takon pikëpamjes së M.Krujës lidhur me dokumenta që, po qenë të shkruara veçanërisht nga studjues të huaj dhe sjellin ujë në vijën e mullirit të historianëve shkarravitës të historisë kombëtare, merren si fakte historike të mirëfillta. Tek i citon frati se çfarë ka shkruar studjuesi italian Giannini rreth kërkesave të Kongresit të Lushnjes lidhur me kufijtë tonë kombëtarë, M.Kruja replikon me një pozicionim studjuesi të mirëfilltë ... Për mue ai tekst është apokryf (me autenticitet të dyshimtë - shënim i M.K.).

Do t'a besojshem vetëm kur të më provohej me dokument autentik, b.f. (bie fjala – shënim i M.K.) me proces – verbalin e nënshkruem prej delegatvet ase një kumtim diplomatik t'atij kongresi kancelarive të hueja. Giannini ka gabime edhe n'atë pjesën tjetër ...

Me këtë rast nuk kam se si të mos i kthehem edhe një herë atij që do t'a quaja postulati i M.Krujës, i cili duhet të jetë A-ja e moralo – etikës së studjuesit të historisë: “ Miqsija e mirnjohja janë sende të shënjta, por ka përmbi ta një gjà tjetër edhe më të naltë : e vërteta !” Dhe kërkimi i kësaj të vërtete i përshkon të gjitha letrat e përgjigjeve që M.Kruja i drejton fratit.

Përgjatë të gjithë letërkëmbimit bije në sy edhe një element shumë i veçantë i mënyrës së të shkruarit të M.Krujës. Se sa konçiz ishte ai, del në pah në dy përgjigjet që i jep Padres lidhur me personalitetin e fortë e karakterplotë të Luigj Gurakuqit. Rasti i parë është tek përshkruan skenën e ngjarë në shtëpin'e nipit të Ismail Qemalit, Xhemil Bej Vlorës ku e kishte selinë akoma qeveria e porsadalë mbas shpalljes së mëvehtësisë. Përshkruhet se si i zoti i shtëpisë i drejtohet me përçmim Luigj Gurakuqit duke i thënë ushak, (turqisht – shërbëtor – shënim i M.K.), shprehje përbuzëse me të cilën Xhemil Beu aludonte marrëdhënjet në mes L.Gurakuqit si edhe I. Qemalit. E Gurakuqi ç'qëndrim mban ? Ja si e përshkruan M.Kruja skenën : ... Gurakuqi u çue si rrufeja e i mbet me një paravesh (shuplakë fytyrës – shënim i M.K.) turijve. Tjerët e kapën beun e e çuen në harém te gratë e s'u bâ më kurrfarë reaksioni. Luigji s'e hiqte n'ato kohna të turbullta kurrë alltijen (koburen – shënim i M.K.) nga brezi ... (Fq.219–220).

Rasti tjetër i një qëndrimi të papërkulshëm të Gurakuqit, ka lidhje me Faik Konicën. Ishte viti 1914. Esat Pashë Toptani, sipas mendimit të shumë patriotëve, ishte tradhëtar. Italia e mbështeste atë. Faik Konica bashkëpunonte ndërkohë me E.Pashën. Një grup patriotësh caktojnë L.Gurakuqin që të përgatiste një dokument i cili do t'i paraqitej Princ Wiedit. U mbledhën në Durrës shumë intelektualë që t'a miratonin dokumentin, mbasi t'i bënin vrejitet që mendonin. Sapo del Gurakuqi para tyre me dokumentin në dorë që t'a lexonte, (vazhdojmë tani me fjalët e M.Krujës) ... Faik Konica s'e lën me çelë gojë : Ç'janë ato intriga italiane (?) këlthet (Konica – shënim i M.K.). Gurakuqi edhe s'bani tjetër, veç për lau shkopin qi kishte atje pranë dhe ia veshi krës si një rrufë. Gjindja u çue në kambë, hyni ndërmjet e n'emën t'Atdheut, vûni paqë. U ndëgjuen spjegimet, u këndue memorandum, u pëlqye pa asnjë ndryshim, pa asnjë objeksion as prej Konicës e puna mbaroi me kaq. (Fq.225). Paraqitin interes të veçantë në këtë kontekst pikëpamja e fratit lidhur me incidentin e gjithashtu përgjigja që i jep M.Kruja Padres. (Fq.229) Padreja është çuditur se si Konica i hodhi Gurakuqit fjalët ... Ç'janë ato intriga italiane dhe vazhdon ... Luigji e tjerë nacionalista bashkëpunojnë me Wiedin kundra Esatit, i cili asht i ndihmuem e i prujtun prej italianvet, e si mund t'i hidhet Luigjit kjo fjalë ? E M.Kruja i përgjigjet “... Paj duhet me e pasë njohun Konicën. Cili shqiptar s'ka qënë për të tradhtuer, intrigant, vagabond, kusar, ignorant, etj.etj.?

Ai Luigjit s'i ka lënë vënd në vorr, se jo m'at kur ishte gjallë..." (Fq.233).

Në vazhdim lexuesi do të verë re se kemi kapërxime periudhash kohore. Kjo nuk shpreh moskujdesje nga ana e ynë, porse stilin pindarik me të cilin Padreja i drejton pyetjet. Megjithatë secila pyetje si edhe përgjigjet, në bashkësinë e tyre, hapin dritare që kanë qenë të mbyllura dhunshëm duke filluar që nga periudha e diktaturës e në vazhdim që të vërtetat të mos e shihnin dritën e diellit por të rrinin e t'i mbulonte tisi i harresës nëpër fondet e ndaluara të arkivave të ndryshme !

Përgjatë vazhdimit të letrës me nr.59, Padreja shtron tezën e tij se si lidhur me çfarosjen e elitës shqiptare fajin e kanë serbët që e dinin se si nuk mund të kishte patriot shqiptar i cili të mos ishte antiserb dhe vazhdon shprehimisht ... Mbas mendimit t'em prë, Enver Hoxha me klyshat e vet të kuq, s'ka bërë tjetër veçse me çue në vend urdhnat e Belgradit që prë, simbas mendimit t'em, e ka plotsisht fajin e shfarosjes s'elitës shqiptare ... (Fq.230) Nuk shmangemi pa e vënë në dukje objektivitetin e fratisë që krim primar quan hartimin e listave të personave për t'u pushkatuar, ndonëse vazhdon duke pohuar se si ... Mbas gjaset, edhe po t' mos ishin kenë urdhnat e Belgradit, do t'ishin kenë shqiptarët vetë që me u derdhë trutë vllazënve të vet shqiptarë ... Si thue ti ? M.Kruja përgjigjet : "... a i ka fajin pyllit spata apo bishti ?" (Fq.234).

Por në vazhdim pastaj ai, duke i bërë një analizë diferenciale të një niveli tejet të thellë problemit, e çon Padren drejtë përfundimit se kur një armik arrin e fut përçarje në familje, si në rastin tonë ku vëllai vret vëllanë për të qenë parë, kurse armiku do t'a gëzojë grabitjen që po përgadit (Kosovën), padyshim që faji kryesor dhe më i madh u mbetet shqiptarëve ! Kjo sa i takon krimit të madh të zhdukjes së elitës të kombit tonë. Në vazhdim pastaj nuk ka nevojë për koment qëndrimi i qeverisë komuniste shqiptare nga njera anë lidhur me problemin e Kosovës e pa le pastaj se si, mbas aneksimit të saj Federatës Jugosllave pa plebishit, (votim i përgjithshëm popullor – shënim i M.K.), kur pyetet Enver Hoxha gjatë Konferencës Paqës në Paris më 1946-ën lidhur me marrëdhënjet Jugosllavi – Shqipëri, (ku pyetja i drejtohet me tendenciozitet), ai përgjigjet : "... Ne nuk kemi asnjë problem me Jugosllavinë, përkundrazi ... " Duke e lexuar këtë pohim profesorët tanë historianë në dokumentat lidhur me Konferencën e Paqës të Parisit të vitit 1946, e kuptoj se janë gjëndur para vështirësishë

por, me që ato vështirësi si edhe të tjera partia dhe komandanti u kishin thënë se duhej t'i kapërxejnë, historianët ashtu bënë. E pastaj në vazhdim doemos edhe u specializuan dora-dorës në këtë drejtim e s'pati më vështirësi që ata të mos i shmangnin dot, doemos jo pa ndihmën e partisë mëmë !

Letra me numër 61 e shkruar prej fratisë dhe e drejtuar M.Krujës, mund të thuhet pa as më të voglën frikë, se është një dokument ku ndërthuren hulumtimet e bëra nga frati rreth së vërtetës lidhur me veprimet e karakterit "tërhiq e mos këput" të nacionalistëve shqiptarë, në ballafaqim me politikën italiane, për të arritur maksimumin e të mirave të mundëshme në favor të Shqipërisë, ku sinteza e Padres bëhet bartëse pyetjesh kardinale nga ana e tij. Frati citon pohimet e studjuesit gjuhëtar edhe historian Kostë Çekrezit, (botues në Londër më 1919-ën i punimit Shqipëria, e kaluara dhe e tashmja – shënim i M.K.), i cili në një fashikull botuar nga fundi i vitit 1951 në Washington shprehet se pas dështimit të lëvizjes së Fierit ... parësia e vëndit dhe jo vetëm bejlerët, arriti në përfundimin logjik që, mbasi Zogu mbahej në fuqi me anën e përkrahjes që kishte nga Italia Fashiste, e vetmja rrugë për t'a hequr qafe ishte q'ata, si të parët e vëndit, të bënin një marrëveshje direkte me qeverinë e Romës. Ndërmjetës për këtë marrëveshje ishin Shefqet Bej Vërlaci i Elbasanit dhe Mustafa Merlika i Krujës. Marrëveshja u plotësua në Dhjetor 1938. E mbasi shtron pikëpamjen e Çekrezit, frati e fton M.Krujën t'ia kthellojë mirë rrethanat, pozicionimin e Italisë si edhe përzgjedhjet që detyrohet të bëjë paria e emigracionit shqiptar, nisur gjithënjë nga parimi i veprimit sa më në favor të interesave kombëtare shqiptare. Në faqet 239 e deri në faqen 248, M.Kruja i bën Padres një paraqitje të plotë e me të gjitha detajet, (të cilat pikë për pikë gjenden në Arkivin e Shtetit Shqiptar si edhe në Arkivin e Ministrisë Jashtme të Italisë – shënim i M.K.), duke treguar hapat e ndërsjella të ndërmarra përgjatë bisedimeve si nga përfaqësuesi i qeverisë fashiste italiane Giovanni Giro e nga ana tjetër nga ana e M.Krujës si i caktuar të përfaqësojë të katër grupet e nacionalistëve shqiptarë jashtë Atdheut mëmë. Është qartë se vetëm leximi i plotë i atyre dhjetë faqeve shkruar nga M.Kruja në sqarim të pyetjes fratisë, e ndriçojnë lexuesin. Megjithatë, me pak rrjeshta të mjitë sa për t'a ngjallë kërshërinë e mëtejshme të lexuesit, do të cek ndonjë moment kulmor pozicionimi nga ana e M.Krujës sipas marrëveshjes me grupet nacionaliste.

ARRITI NË KOSOVË SEKRETARI I SHTETIT TË VATIKANIT, HIRËSIA E TIJ KARDINALI, PIETRO PAROLINI

Është hera parë që një Sekretar Shteti i Selisë së Shenjtë e vizitojë Kosovën!

Sekretari i Shtetit të Vatikanit, Hirësia Tij Kardinali Pietro Parolin arriti me 9 qershor 2019, për një vizitë dyditore në Kosovë. Është hera parë që një Sekretar Shteti i Selisë së Shenjtë e vizitojë vendin tonë, prandaj kjo vizitë mori një domethënie të veçantë, në shërbim të së mirës e mbarë shoqërisë së vendit duke u'a sjell të gjithëve pa dallim: afërsinë, dashurinë dhe bekimin e Papës Françesku. Përveç takimeve të tij me hierarkinë e komunitetin katolik e kremtimit të eukaristisë, Sekretari Shtetit të Vatikanit pati edhe takime tjera e dorështerngime miqësore me përfaqësues kryesor të komuniteteve islame, bektashinj, hebrenjve etj.

Mesha e djeshme e Rrëshajave e orës 11:00, u mbajt në kon katedralen “Nëna Tereza” në Prishtinë, e cila u celebrua nga Kardinali Parolin, e përcjellë nga imzot Dodë Gjergji, mons. Lush Gjergji, mons. Zef Gashi, e shumë meshtarë të tjerë. Me atë rast nga ana e Kardinalit Parolin, të rinjve të famullisë së Prishtinës, Ferizajit, Llapushnikut etj, i'u nda Sakramentit i Krezmimit. Menjëherë pas përfundimit të meshës shënjte në kon katedralen “SHËN TEREZA” në Prishtinë, u organizua një koktel rasti ku disa nga të pranishmit patën mundësi të takonin Hirësia Tij, Kardinalin Parolin. Ishte edhe zëvendës kryeministri i Kosovës, z. Enver Hoxhaj, Naim Ternava, kryetar i BIK-ut, etj. Ishte edhe një kënaqësi për mua si një gazetar i pavarur e takova, Kardinalin Parolin, të të cilit i'a dhurova librin tim monografik: “Dritë mbi gjurmë të Imzot Mark Sopit”.

Ndërsa në mbrëmjen e djeshme të ditës së Rrëshajave, në orën 18:00, Sekretari i Shtetit të Vatikanit, Hirësia Tij Kardinali Pietro Parolin, pati një shtegtim e meshë tjetër të radhës në Katedralen “Zoja Ndihametare” në Prizren, ku në bashkëmëshim me imz. Dodë Gjergji, Ipeshkëv i Dioqezës Prizren-Prishtinë, mons. Lush Gjergji, imz. Rrok Gjollleshaj, Arqipeshkëv i Tivarit, mons. Zef Gashi, dom Fran Sopi, dom Alfred Sokoli etj. Rishugurimi i Katedrales së rindërtuar e restauruar rrënjësisht mirë është bërë nga Eminenca e Tij, Kardinali Pietro Parolin e autoritetet të tjera te larta te Kishës Katolike të Kosovës, para popullit të zgjedhur te Zotit që ishin pjesëmarrës të meshës së mbrëmjes në rishugurim të katedrales “Zoja Ndihametare” në Prizren. Rishugurimi është bërë duke u nisë me ritet fillestare eukaristike, bekimit të ujit dhe sperkatjes, liturgjisë së fjalës, lutjes e kushtimit e lyerja me vaj, lyerja e altarit me vaj dhe mureve te katedrales,

kemosja e altarit dhe katedrales, ndriçimi i altarit dhe katedrales.

Në meshën e rishugurimit të Katedrales morën pjesë (nga vrojtimi im) strukturat e larta ushtarake të KFOR-it, kleri i komunitetit islam, bektashinj e ortodoksë si dhe shumë përfaqësues të spektrit politik në nivel shtetëror e lokal si: kryetari i Prizreni, z. Haskuka, Dr. Pal Lekaj, ministër, Anton K. Berisha, zv/ministër, Anton Quni, deputet i parlamentit të Kosovës, z. Sali Cacaj, ish/ këshilltar i Presidentit Historik, dr. Ibrahim Rugovës e shumë e shumë deputet e njerëz të kulturës edhe nga mbarë bota shqiptare duke veçuar edhe Drejtorin e Pallatit të Kulturës së Rrëshenit, prof. Gjergj Marku.

Pas përfundimit të meshës, me një fjalë rasti u paraqit, Vikari Special i Dioqezës, don Shan Zefi, e famullitar i kishës së rishuguruar të Prizrenit i cili veq tjerash i falënderoj të gjithë ata emër për emër (Prizreni, Diaspora Shqiptare përfshirë nga Amerika, Gjermania, Tirana... etj) që kontribuuan në rregullimin e kësaj katedrale të vjetër të fundshekullit katër. Ishte edhe kryetari i Prizrenit, z. Haskuka, i cili veq tjerash foli për vizitën e Sekretarin e Vatikanit, Kardinalin Parolin duke thënë se kjo tregon rëndësinë e kësaj katedraleje, por edhe rëndësinë e Prizrenit, i cili si qytet historik, me vlerat e saja të trashëguara është një shembull i bashkëjetesës ndëretnike dhe ndërftare dhe ndër qytetet e pakta në botë ku me një shkrepje të aparatit, në kornizën e ndjetë mund të fotografojmë katedralen katolike, xhaminë dhe kishën ortodokse. Me këtë raste të sotëm ndihet krenar çdo qytetar i Prizrenit dhe kjo më bën krenar edhe mua si kryetar i kësaj komune. Uroj që ky dialog dhe bashkëjetesë të vazhdojë gjithmonë dhe ne të shërbejmë si shembull i paqes për gjithë njerëzimin tha në fund të fjalës së tij, z. Haskuka i cili më pas i dhuroj disa dhurata Kardinalit Parolin.

Pas përfundimit të rishugurimit të katedrales së Prizrenit, për të gjithë të pranishmit u shtrua një koktej rasti.

Më dt. 10, qershor, Kardinali takojë autoritet qeveritare shtetërore dhe më pas takimi me klerin dioqezan, rregulltarët dhe rregulltaret, katekistët dhe bashkëpunëtorët laikë, në Qendrën “BogdaniPolis”. Sekretari i Shtetit të Vatikanit, Hirësia Tij Kardinali Pietro Parolin, sot në orët e pasdites e përfundoj vizitën e Tij në Kosovë dhe u kthye në Vatikan.

Shkruan: Lekë Mrijaj

7 SHENJTORËT THEMELUES TË SHËRBËTORËVE TË LUMES VIRGJËRËS MARI

Më 1888 Papa Leoni XIII shpalli shenjtër 7 etërit e parë të Urdhërit të Shërbëtorëve të së Lumes Virgjërës Mari, që janë varrosur në një varr të përbashkët në Malin Senario, aty ku patën jetuar së bashku

Më 17 shkurt kalendari i Kishës katolike kremton Shtatë Themeluesit e Urdhrit të Shërbëtorëve të së Lumes Virgjërës Mari.

Në Firencën e shekullit XIII, të pasur me kulturë e me para, udhëkryq idesh e luftërash ndërmjet guelfëve e bigelinëve, nuk munguan burra e gra që praktikonin jetën ungjillore.

Kështu, sipas traditës, rreth vitit 1233, kur Firenze tronditej nga luftërat vëllavrasëse, shtatë tregtarë fiorentinë, anëtarë të një shoqërie ku bënë pjesë besimtarë të devotshëm të Virgjërës Mari, u tërhoqën në Malin Senario, pranë qytetit të tyre, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit për t'ia kushtuar plotësisht jetën. Braktisën shtëpitë e nisën të jetonin në lutje e pendesë, sipas modelit të Virgjërës Mari. Të gjitha pasuritë që kishin, ua ndanë të varfërve. Ndërtuan një shtëpizë e një orator kushtuar Zojës së Bekuar.

Nga kjo thirrje nisi lulëzimi i urdhrit të Shërbëtorëve të Marisë.

Njëri nga të shtatët, Aleks Falkonieri, vdiq më 1310, por të tjerët vijuan veprën e tij. Kalonin një jetë të vështirë e vetmitare. Megjithatë nuk u largoheshin njerëzve që, të shtyrë nga ankthi e nga dyshimi, kërkonin prej tyre një fjalë ngushëlluese. Fama e shenjtërisë së maristëve u përhap aq shumë, sa me qindra vetë kërkonin të bashkoheshin me ta. Prandaj vendosën të themelonin një urdhër, kushtuar Virgjërës Mari, pasi e kishin

quajtur veten shërbëtorë të Nënës së Krishtit. Përshtatën Rregullën e Shën Agostinit.


Më 1888 Papa Leoni XIII shpalli shenjtër 7 etërit e parë të Urdhërit të Shërbëtorëve të së Lumes Virgjërës Mari, që janë varrosur në një varr të përbashkët në Malin Senario, aty ku patën jetuar së bashku. Mbi rrasën e këtij varri të thjeshtë, si jeta e tyre, lexojmë shtatë emra: Shën Bonfiglio, Shën Bonagiunta, Shën Maneti, Shën Amadi, Shën Sostenjo, Shën Uguçione, Shën Aleksi – që në shqip tingëllojnë pak a shumë: Birmiri, Bashkimiri, Dorarti, Ndihmëtari, Barabarti.... Maristët tashmë janë me mision edhe në Shqipëri e pikërisht në Vlorë





MJEDOLOGJI 5

Botime FISHTA,
Lezhë 2019



Alfred Çapaliku

NJI JETË PËR FE E ATDHE

Arqipeshkvia Metropolitane,
Shkodër - Pult 2019



Lutfi Alia

**SANXHAKU I SHKODRËS
NË VITIN 1614**

Shkodër 2019

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXII, nr. 5/6 (519-520) Maj - Qershor 2019